

SHËZAT

LE
PLEIADI

VII, 1963

1-2

SHËJZAT

[LE PLEIADI]

E përkohëshme kulturore, shoqërore
e artistike

Rivista culturale, sociale ed artistica

Vjeti VII n. 1-2 Kallënduer-Fruer 1963
Anno VII n. 1-2 Gennaio-Febbraio 1963

Drejtuer Përgjegjës
Direttore Responsabile

MATILDE MANCINELLI

Kryeredaktor - Redattore capo

MARTIN CAMAJ

Selija e Redaksisë dhe e Administratës:
Sede della Redazione e Amministrazione:

Drejtesa për letra e lajmime:
Indirizzo per la corrispondenza:

PIAZZA DELLA BALDUINA, 59

Dorshkrimet, dhe në qoftë se s'botohen,
nuk kthehen.

I manoscritti, anche se non pubblicati,
non si restituiscono.

Pronar - Proprietario
ERNEST KOLIQI

Derdhja e pajtimeve - Versamenti:
Conto Corrente Postale 1/23626

PËRMBAJTJA

Sommario

HILUSHI:

Fjala qet fjalën (Una parola tira l'altra).

K. G.:

Mëshë për shpirtin e Papas Petrotës
(Messa in suffragio di Papas Petrotta).

G. VALENTINI S.J.:

Le caratteristiche funzionali dell'attività culturale di Papas Gaetano Petrotta (Vetit funksjonale të veprimtarisë kulturore të P. G. Petrotës).

KARL GURAKUQI:

Prof. Gaetan Petrotta, letrár e patriot
(Prof. Gaetano Petrotta, letterato e patriotta).

VOREA UJKO:

Vjerrsha (Versi).

FRANZ BABINGER:

Pinjollit i fundit i Familjes s'Arianitashvet (L'ultimo rampollo della Famiglia degli Arianiti).

GIUSEPPE GRADILONE:

Le poesie del Vescovo Giovanni Mele (Vjerrshat e Ipeshkvit Mele).

EKREM VLORA:

Dy pamje nga historia krahinore e Shqiprisë (Due aspetti della storia provinciale albanese).

ZEF VALENTINI S.J.:

Skjarime rreth Xanonit (Chiarimenti sul Xanoni).

MARIA MUSTILLO:

Gli Albanesi (Shqiptarët).

PRENK NDREVASHAJ:

Mbishënat (novelë).

ERNESTO KOLIQI:

L'Islam e il Cristianesimo nella letteratura albanese (Islamizmi e Kështenimi në letërsinë shqipe).

REDAKSIJA:

Nji lajm gazmuer (Una lieta notizia).

Kronikë kulturore (Cronaca culturale)


Libra të lexuem (Libri letti).

Kallënduer-Fruer 1963

Gennaio-Febbraio 1963

Vjeti VII - n. 1-2

Anno VII - n. 1-2



Fjala qet fjalën

nga Hilushi

Papas Petrotta, flamurtar i kulturës shqiptare

Mali arbresh për Shqipni

Çdo Shqiptar zëmër-ndieshëm pushtohet zakonisht nga një përshypje e gjallë çudije kur rasa e qet m'u takue me Arbreshë. I a vën veshin me andje krenare ligjirimt jetik qi stërnipat e bashkëluftarvet të Skanderbeut ruejten me një besnikí kryeneçe e cila pak shembuj tjerë ka në botë edhe dalldiset kur ndëgjon se me sa afsh e gjakim ata përmendin zakonet e përbashkëta, vetit dalluese ethnike, ngjarjet e kalësës. Mâ të shtëjme në mot, vjetërsin e gjuhës, zanafillet e lashta të rracës. Por gabon ai Shqiptar qi përpigjet — me qellim ase pa qellim — t'a ftojë Arbreshin edhe mâ mende-ndritun m'u marrë me çashtëj konkrete t'atdheut të zanafilles, sepse adhurimin për Shqipni ai e ushqen në një mënyrë platonike, tue përkëdhelë me fantazi të vet kujtimin e trashiguem të një visi ideal. Problemet e sotshëme të Shqipnis Arbreshi nuk i njeft as nuk i ndien, pa lodhë mendën mirë e mirë në to dhe, deri sa mos të hËjje thellësisht në palc të tyne, pikpamja e tij jet larg prej s'onës. Shpirti i dridhet njëpërnji me t'onin vetëm kur flasim për fisnikí të rracës, për etimologjin e fjalve shqipe, për nâmin kombtar; përgjithsisht, prá, për vlerat stërgjyshore të gjakut të përbashkët. E kjo ásht punë e madhe. Mâ të mirët ndër Arbreshë ndiejnë shkaset e hovshëme të nderit shqiptar si na. Së naqámeve, gërgasavet të hueja, qi cenojnë sedren e kombësis, ata u kundërshtojnë rrëmbyeshëm si na. Mbas pesqind vjetvet jo vetëm qi krenija e Arbërit nuk ásht shue në gjak të tyne por ásht fuqisue.

Shqiptarët e Shqipnis, sidomos ata qi paten rasa të rralla me ardhë në përpjekje me të huej, krenin shqiptare e ndiejnë shum mâ pak në vetvete. Jeta e tyne, tue u zhvillue në vend edhe në rreth të bashkatdhetarvet, ndeshet e përplasat mâ tepër n'ashpërsit e rrebevet të natyrës shqiptare, kështu qi mâ shum lëvitë mbrenda tyne krenija e ngushtë e shtëpis, e lagjes, e krahinës se sâ ajo e gjânë kombtare.

Arbreshët, përgjithësisht, tue i pasë hjedhë fati me jetue midis nji populli të huej, domosdo e kanë mâ të hollueme ndijen e krenis ethnike.

Dy Arbreshët e viganshëm. Jeronim De Rada e Zef Skiroji senior, apostullatën e tyne në dobi të shqiptarizmit e ushtruen në dy ballna të ndám njâni prej tjetrit. Në nji anë ata derdhën mundin e tyne të shkëlqyeshëm për të ngjallë e forcue ndër Shqiptarë dishirin e vullndetin e liris, flakën e vllaznimit, vetedijen kombtare; por n'anën tjetër mprefën të gjitha mjetet e mendesquetis dhe të ditunis së tyne me përgënjeshtrove shpifjet e përhapuna nëpër botë të jashtëme mbi Shqiptarë edhe me parashtrve, sidomos në qarqe kulturore, vlerat ethnike si dishmí e provë pjekunije për krijimin e nji Shqipnije në vete e për hÿmjën e saj të lir e të pamvarun në familjen e shteteve europjane. Veprat «Divinazioni pelagiche» (1840), «Antichità della Nazione Albanese» (1845) e «Pelasgi e Albanesi» (1890), De Rada i a drejton posaçerisht të huejvet për të tërhjekë vërejtjen e tyne mbi çâstjen e harrueme të kombësis shqiptare. E disa pohime fyese mbi Shqiptarë edhe mohuese të drejtave të tyne flakrue prej Grekvet e neverisin. I këcen nji dell në ball prej idhnimit dhe në fletoren «Fiàmuri i Arhërit» (1883-1887) polemizon rrebtas me Grekë tue qitë argumenta të papërgënjeshtroeshëm mbi drejtësin e mtimeve kombtare të Shqiptarvet. Gjithashtu Skiroji. Jo vetëm në pjesën e veprës së tij me karakter historik e ndër studime letrare. por edhe në poeme e vjerrsha mban para sÿsh shkarkimet e thanethashat poshtnuese qi qarkullojnë ndër të huej mbi natyrën barbare të Shqiptarvet, mbi doket prapanike dhe mbi pazotsin e tyne me krijue nji shtet në vete. Ligjiratën e njoftun mjeshtrore qi ai na la mbi zhvillimin historik të letërsis shqipe e nisë tue tregue se si Turkoshakët na quejshin «kitab-syza» né Arnautët e shtojshin se librin Shqiptarit i a ka ngrânë buelli. Kaq i ka mbetë në trû puna se Shqiptarët paditen nga anmiqët e kombësis së tyne si njerz t'egjër dhe të padepërtueshëm nga fryma e qytetnimit, saqi edhe në vjerrshë gjën menyren me naltësue cilsit e rracës tue u shprehë prémas si t'ishte kah i flet nji dashakeqi shpifës.

Mendegjânsija e Papa' Tanit

Merita e Papa' Tanit në mprojtje të vetive kombtare qe edhe mâ e gjânë, në nji farë veshtrimi, se ajo e De Radës dhe e Skirojit.

I pari shkroi e veproi në nji kohë përpjekjesh ideale pa hijet qi mâ vonë u shtrin mbi çâstje shqiptare për shkak lakmish egoçentrike dhe qellimesh së turbullta të vendasvet. Skiroji vdiq i mërztun në shpirt. Xhevahiret e fundme të gojtaris s'tij ai i shprazi, bashkë me lot të nji pikllimí zemërshporues, mbi trupin e dekun të Gurakuqit në vorreza të Barit me 1925.

Sado qi Papa' Tani (kështu në zbunim dashunuer e thirrshin t'a fërmit dhe Ai mÿrsisht na lëjonte edhe né qi kështu t'a thirrshim) pau

se Shqipnija, e mkambun mbi themele shtetnore të pamvaruna, nuk doli ashtu si patriotët, në datsh shqiptarë në datsh arbreshë, e andrruen; sado qi pau edhe se shteti i rilindun pak e aspak i përfillte Arbreshët qi aq përkrahje e kishin dhënë lëvizjes për rilindjen kombtare, prap se prap nuk e paksoi zellin e një veprimtarije kushtue kryekëput vlerësimit në botë t'emnit shqiptar.

At Valentini në fjalimin përkujtimuer mbajtë në Palermo me rasën e dhetëvjektorit të zhdukjes së Papas Petrottës, hollsisht e depërtueshëm, si e ka zakon, gjën në mbrendin më të thellë të veprës kulturore të Tij frymën e veçantë, shkasin qendruer qi i a vënte në lëvizje shqisen. Me shprehje plot njerzi, don t'a lajë kritikën letrare të Petrottës nga e mbeta qi i ngarkohet se asaj i mungon prospektiva, mbasi qi në të s'ka një rendim vlerash, por vëhen në një rrafsh të njëjtë krijuesa bukurish të larta poetike të cilat i a shtuen pasunin shpirtnore e aftësin shprehëse kombit me shkrimtarë rendi të dytë a të tretë pa vetina të shënueshme as në përmbajtje as në trajtë të veprave. Radhiten në një shkallë pa dallim auktorë librash me shkruesa artikujsh.

Na kemi pasë fatin t'a njoftim Papas Petrottën dhe e dijmë qi nuk i mungonte shija letrare. Por jemi të bindun se Ai, ashtu si mendon edhe At Valentini, ushqente të njëjtin qellim qi nxiti pendat arit të De Radës dhe të Skirojtit me qitë në shesh e me pilue para të huejvet e para vetë Shqiptarvet sasin e prodhimit kulturuer t'onë. Ai i a lën të tjerret zyrën e zqjedhjes së landës, peshimin e saj në terezin e kritikës, rrjeshtimin e auktorvet në rend gjerarkik simbas vlerës. Ai synon me bâ mbledhjen e landës, një «inventarium» madhënuer të gjith prodhimit albanologjik, një parashtresë tronditëse të përfundimeve t'arrijtuna në çdo fushë të kulturës shqiptare. Ai don qi vepra e Tij të jët hambari i korraëve të vjetra e të reja qi u poqën në lamije të kulturës arbnore.

Pasunin e vlerave të kulturës s'onë Ai e shtron në mënyrë unjisore (unitaire) tue i rendue kronologjikisht auktorët, pa i dallue në Shqiptarë e Arbreshë, por njënin mbas tjetrit si degë të një trunku.

Kultura si armë mproje

Nuk duhet harrue qi, për shumicën e Arbreshvet, ndiesit fetare njëpërnjisohen me dashunë për gjuhë e për tradita shqiptare. Ku lulzon riti bizantin, qindrojnë më të forta lidhjet shpirtnore me atdhën e zanafilles. Në menden e në zëmrën e Papa' Tanit apostullata fetare e ushtrueme me botim në gjuhë shqipe të së përjavëshmes «Fjala e t'in' Zoti» perzihet e shkrihet me veprimtarin qi i kushton veprimin për rilindjen e Shqipnis. Për një prijt dhe për një njeri kulture, kuptohet vetvetiu se arrijtjen e qellimeve të veta i a beson zotsis kulturore. Kultura âsht edhe arma e Papa' Tanit. Ai merr pjesë në të gjitha lëvizjet qi synojnë fuqisimin e kombit shqiptar në fillesat e jetës shtetnore. Bashkëpunon në fletore e në të përkohëshëme, mban konferenca, ndodhet pranë në kongrese, përpilon e nënshkruen memorandume.

Në marrëdhânjët e Tija me rrethet ndërkombtare të studjuesavet, vën roe se sá pak e njoftun âsht çâshtja shqiptare dhe se sá paraggi-kime megjullojnë aspektet e saja edhe ndër njerz vullndet-mirë e shum të peshuem në gjikim. Besojmë se kjo arsye e shtÿni me grumbullue

në vëllimin enciklopedik të stërgmueshëm të Tij «Popolo, lingua e letteratura albanese» të gjitha njoftimet që i përkasin Shqipnisë e Shqiptarvet. Ai me atë u thotë të huejvet dyshuesa e Shqiptarvet që nuk besojnë në vetitë e veta: «A shifni sa e tërhjekëshme është letrësija gojore e popullit t'onë? A shifni sa shumë shkrimtarë ka qitë Shqipnija dhe sa shumë fletore, revista, libra janë shkruar në gjuhë shqipe?».

Vepra e Papa' Tanit para të huejvet është një diplomë zotsije për rracën t'onë.

Vlerat e botës shqiptare


Kush shkruen këto rradhë pati fatin e nderin t'a két Papas Petrottën si këshilltar në botimin e një vepre, që nga shkaku i kohës së shqetë në të cilën u botue kaloi pa u njoftë sa meritonte për landë vërtë interesante grumbullue e rendue më së miri në të. E kam fjalën tu antologjija «Bota shqiptare» (Botim i Ministris s'Arsimit, Tiranë, 1943). Jam i bindun se mbetet edhe sot një ndër botime më të spikateshme që dolën në vend t'onë. Qe e Petrottës ideja-nënë me paraqitë si në një film karakteristikat e ngjyrëshme të tokës s'onë dhe vlerat shpirtnore të fisit arbnuer.

Bashkë sajuem rrvazimin e vëllimit që tjerë bashkëpunorë të shquem plotësuen tue zgjedhë copa, në përkim me idën-nënë të vepres, ndër shkrimtarë t'onë dhe ndër albanologë të huej: copa të ngjyrëshme, të gjalla, që ngulen në mend. Edhe në këtë pasqurë të trashigimit stërgjyshuer Papa' Tani deshëronte sidomos të shpaliste anat nierzore të mbrûmjes s'onë si popull në rymbën e kavaljetave. Një popull që në themel të botëkuptimit të vet ka nderin, besën e burrnin nuk mund të quhet i mbrapambetun. Një komb që tri perandorive nëpër të cilat u përshkue, — romake, byzantine e osmane —, u dhuroi perandorë e qeveritarë e krye-luftarë zâmëdhej, nuk mund të quhet i paqytetnuem. Një fis (stirpe) që dijtë të mbajë të papërkulun krenin e brumit etnik të vetin mbrenda e jashta dheut të të Parvet, nuk mund të quhet i padëjë m'u rreshtue në një vijë me kombe tjera t'Europës e të rrokullis toksore. Kët dishmí donte Papa' Tani me u paraqitë Shqiptarvet dhe të huejvet, atyne për t'u a forcue besimin në vetvete dhe këtëme për t'i bindë se ndodhen para një populli trim por edhe zëmërbardhë, krenar por edhe të ndershëm, mikpritës e fisnik.

Ai me shembullin e punës së cenëshme që u kushtoi qjuhës shqipe e albanologjis, me frymën që përshkon fund e majë studimet e Tija të gjâna, më kërcimet e dellit të krenis që i a bâinë të lëvizuna faqet e vepravet, qartas na lën këtë porosi: «Jo vetëm të huejët por as na s' i a dijme vlerën vetvetes. Fisi arbnuer ka mende të sqet dhe zëmër kejë të ndieshme. Vetit t'ona pasqyrohen në letërsin gojore, ku kanga e vaji i breznive të sosuna kumbon e vrumulisë me një bukuri të naltë njerzore. dhe në veprat e shkrimtarvet t'onë. Shqipia, shpendi totemik i fisit, lindi zoqj që mrekulluen kohën e vet me fluturime t'epëra. Studioni doket, kërkoni ndër palët e mshefta të shpirtit, mblidhni e hulumtoni pasunin shprehëse kolektive, shtjerrtoni imtimet e zanafilles s'onë, me pak fjalë: fuqisoni kulturën shqiptare sepse ky është mjeti kryesuer për të qitë në shesh thesaret e mëdhaja ende të mshefuna në qjinin e kombit dhe për të fitue çmim e nderim kundruell kombeve tjera».

Ky Arbresh zëmërmadh që bâni me valavitë në lamije t'albanologjis flâmurin e kulturës shqipe, na lën një shembull që duhet ndjekë.

Meshë për shpirtin e Papas Petrotës



Dhetëvjetori i vdekjes së Papas Gaetan Petrotës, puntuer i palodhëshëm në fushën e letravet shqipe e të traditavet arbreshe, u përkujtue me 20 kallënduer të këtij vjeti në Kishën « Martorana » të Palermës me një meshë përshpirtjeje, këndue nga Epishkopi i Arbreshvet të Sicilis, Emzot Zef Perniciaro.

Kisha ishte mbushë me njerz, në mes të cilvet dalloheshin farefisi i të ndiemit, një përfaqsi e ish-nxânsvet të tij, rektori i universitetit të Palermës prof. Ajello, Cav. Vadalà sekretari i fakultetit të letravet, prof. Caramella, prof. Gurakuqi bashkëpuntori i ngushtë i të ndiemit, prof. Lavagnini, dr. Bevilacqua asesor bashkijak i turizmit, miku i tij prof. Collura, qi e ká përyetsue me një ritratë mjeshtrorë, qi shifet në njënen nga sallat e Bibliothekës Comunale të Palermës, etj. etj.

Në mbarim të meshës, fytyra e Papa Tanit u përkujtue me një ligjeratë të zgjedhun nga prof. Zef Valentini, pas-ardhësi i tij në katedrën e shqipes. Ky vûni në dukje rândësin e përpjekjevet të përditëshme të prof. Petrotës, mendja e të cilit ishte e prirun mâ së forti kundrejt zbulimit të vleravet të traditës së tokës së vet të zânafiles. Të gjitha botimet e Papa Tanit — tha Valentini — ishin të frymzueme prej këtij drejtimi, ndër të cilat spikatë kryevepra « Popolo, Lingua, Letteratura Albanese ».

Mbas ligjeratës mortore, të pranishmit i paraqitën vëllaut të të ndiemit, dr. Rozolin Petrotës, ngushllimet e rasës.

Edhë na të « Shêjzavet » e qajmë humbjen e prof. Gaetan Petrotës dhe çfaqim urimin qi t'a shofim të ribotueme sá mâ parë kryeveprën e tij, simbas proponimit të bâmë në Kongresin e dytë të Palermës nga prof. Ernest Koliqi.

K. G.

Le caratteristiche funzionali dell'attività culturale di Papas Gaetano Petrotta

di G. Valentini S. J.

*(Dal discorso tenuto dopo la S. Liturgia celebrata nella Chiesa della
Martorana in Palermo il giorno 20 gennaio 1963)*

Quanto mai suggestivo è il quadro nel quale siamo raccolti a commemorare la figura di uno di coloro a cui maggiormente si deve se questo augusto tempio è tornato alla sua antica funzione di chiesa cattolica bizantina, ed è la concattedrale dell'Eparchia Albanese di Sicilia, e ben possiamo dire la cattedrale bizantina di Palermo: Papas Gaetano Petrotta.

Non possiamo in questo tempio trattenerci in contemplazione, non possiamo seguire le ardite e commoventi modulazioni delle melodie che la nostra cattolicissima comunità ha conservato vive e palpitanti quanto fedeli lungo i secoli, senza alzare lo sguardo a queste volte preziose di aurei mosaici, senza abbassarlo a queste transenne e a questo pavimento di astratto ma parlante disegno cosmatesco; e le une e le altre ci parlano un linguaggio antico insieme ma eterno e reviviscente, non solo nel culto dell'antico rito, ma anche nella rinascente austerità che all'arte sacra fornisce le ali dell'astrazione spirituale.

Questa è una chiesa; veramenti il tempio di una religione. Ogni religione, e fra tutte le religioni in impegno incomparabilmente più vivo, la religione cristiana è conservatrice e rivoluzionaria nel più alto senso perchè per le più alte e profonde ragioni.

Religione cristiana è considerare ogni essere, e specialmente ogni essere umano, creatura di Dio, e come tale, opera dell'arte divina che reca in sé un'impronta della mano del suo artista, e nella propria attività, tanto più se consapevole, una luce del suo volto invisibile:

ἐσημετώθη ἐφ' ἡμᾶς τό φῶς τοῦ προσώπου σου, Κύριε (è segnata su di noi la luce del volto tuo, o Signore).

Nulla di essi ci deve andar latente o smarrito, sotto pena di renderci irricostruibile il volto di Dio, che noi solo da tali elementi possiamo comporre, sia pure con la guida della Divina Rivelazione. Se taluno giace troppo a lungo nelle tenebre della desuetudine, per l'accumularsi su di esso di nuove e nuove cose, la vera e santa rivoluzione sarà quella del coltivatore che arando o vangando la terra, riporterà alla luce quel che giaceva sepolto, e temporaneamente seppellirà ad agire in segreto quel che nell'ultima fase s'era fecondato della luce del sole.

Perciò bene spesso il sacerdote assume la figura del conservatore; di colui cioè che ha la responsabilità della conservazione dei tesori, e bada che non uno ne vada perduto o deteriorato; lungi l'idea volgare del conservatore di museo che tenacemente detiene inoperose delle morte giacenze; ma piuttosto, presente programmatica quella del Vangelo: Πᾶς γραμματεὺς μαθητευθεὶς τῇ βασιλείᾳ τῶν οὐρανῶν ὅμοιος ἔστιν ἀνθρώπῳ οἰκοδεσπότη, ὅστις ἐκβάλλει ἐκ τοῦ θησαυροῦ αὐτοῦ καινὰ καὶ παλαιὰ (simile è ogni maestro addottrinato per il Regno dei Cieli al padrone di casa che sa tirar fuori dal suo ripostiglio cose nuove e cose vecchie). E in ciò ben siamo nella stessa condizione e dello stesso animo, preti e professori che lavoriamo a mantener vive nelle università e negli istituti le antiche discipline e gli antichi monumenti. Perciò, come di istinto, o per provvidenziale disposizione d'animo, il prete è spesso la vestale degli antichi dialetti, degli antichi usi, degli antichi costumi, degli antichi gusti.

Papas Gaetano Petrotta, così, era proprio prete e professore. L'opera sua, perchè appaia scientificamente valida, non va limitata nè centrata nei suoi più squisiti lavori di glottologo. Egli fu, più ampiamente, il conservatore, il tesoriere d'ogni valore della sua nazione.

Ma il suo merito personale, rivoluzionario nel miglior senso, fu quello d'una illimitata larghezza ed accoglienza, fino a rasentare l'indulgente indiscriminatezza. Alludo alla sua opera di storico della letteratura albanese, nella quale seppe far posto al nome di ognuno che avesse messo penna in carta e fatto gemere i torchi.

Non intendo qui di scusarlo o rivalutarlo, ché ne è tutt'altro che bisognoso; basti ricordare che lo storico della letteratura, se effettivamente vuol fare opera di storico e non di critico letterario secondo certi criteri limitati, deve raccogliere ogni cosa per dare un quadro completo e reale d'ogni epoca; tanto più se egli è il primo che tenta una raccolta generale, come nel caso del Petrotta.

Ma c'è ben di più. In realtà, prima di lui, altri piccoli tentativi di una storia della letteratura albanese non erano mancati; ma tutti caratterizzati da una certa chiusura entro i confini d'un ambiente. La dolorosa storia dell'Albania ne aveva fatta una curiosa nazione a due facce rivolte in opposta direzione, come la testa dell'aquila bicipite che tiene nel suo stemma: una a oriente e una a occidente. Anticamente, un'Albania cristiana tutta, ma parte di rito e cultura bizantina, parte di rito e cultura latina. Più tardi, la lunga dominazione turca aveva approfondito il solco fra bizantini e latini, e inserito un terzo blocco mirante ancor più lontano a oriente: i mussulmani; inoltre, la necessità della difesa della propria autonomia avevano resa ogni valle e ogni tribù, ogni villaggio e città e quartiere di città un piccolo esercito sul piede di guerra, attestato dietro una propria trincea. Non fa meraviglia che in ognuno di questi settori si andasse formando una cultura e uno stile differenziato, e che a quelli d'un clan, quelli dell'altro non sembrassero albanesi ma «latini», «slavi», «greci», «turchi», o comunque meno albanesi, privi di civiltà e di cultura, o comunque molto poveri e indegni d'attenzione, e le loro produzioni spirituali e artistiche o incomprensibili o prive di buon gusto.

Occorreva un, diciamo, giudice o arbitro capace di scoprire e rac-

cogliere tutto, senza nulla rifiutare a priori; un giudice dunque senza parzialità, senza scrupolo, senza paura.

Tale era per estrazione il Petrotta: nato non in patria, entro la chiostra d'uno od altro dei piccoli ambienti chiusi, ma nell'antica emigrazione di Sicilia; cattolico di professione come tutti, da sempre, gli Albanesi d'Italia, benchè bizantino di rito, e quindi anche fornito della doppia cultura greca e latina; cresciuto alla scuola letteraria di Giuseppe Schirò, il sognatore, che, nel nome di Dio e della Patria, aveva sempre creduto possibile un'Albania una e concorde e l'aveva cantata nel suo *Këthimi*: dotato soprattutto d'animo profondamente sacerdotale, per il quale non era pensabile un'azione spirituale se non sulla base della stima d'ognuno per i doni che a ognuno Dio ha largito, onde poi sorge la caritas.

Se in lui poteva o doveva esserci uno scrupolo di fedeltà, non poteva essere se non della fedeltà a una vocazione d'universalità, non quello di tradire un interesse sacro, per quanto particolare, o di porgere la mano a un avversario con cui si sia ancora sul piede di guerra. E se una paura, non quella di apparire un traditore, un rinnegato, ai propri consorti.

Non che egli rinnegasse alcun che: non sarebbe stato il miglior modo per conservar tutto; ma due sono le fasi del servizio dei valori: l'una difensiva, in cui quelli che si possiedono si tengon custoditi al di qua di una fossa, di null'altro solleciti se non di mantenerli incommisti, e quindi di chiudere l'accesso ad ogni penetrazione; l'altra di espansione in cui, non più temendo per i propri valori, si riconoscono gli altrui, e pagando questo giusto prezzo se ne ottiene il riconoscimento. In Albania, noi cattolici, praticamente quasi solo latini, si era nella prima fase; Papas Petrotta era nella seconda. Dobbiamo riconoscere che il suo libro non mancò di essere per noi un po' uno scandalo, almeno letterario, anche se da questa idea va detratto quel che di clamoroso che di solito le va associato.

Oggi, a distanza, possiamo ricorrere, invece che all'immagine dello scandalo, sia pure letterario, a quella dell'opera *Ποιητική*, in tutto il senso del termine: costruttiva e poetica. Ci sono infatti dei conservatori di museo, degli archivisti, dei cronisti, degli storici, nella cui mente, nel cui animo e nelle cui mani le vecchie cose sono calde di vita, e vengono fatte rivivere e operare come per un tocco magico: le cose diventano valori. Forse non possiamo dire che in questo l'opera del Petrotta abbia raggiunto allora il suo scopo; il tempo non era a ciò ancor maturo; ma da parte sua l'azione fu già poetica.

Non siamo avvezzi a pensare a Papas Petrotta come a un poeta, specialmente vedendolo affiancato all'atro grande pianiota, il più brillante Giuseppe Schirò. Eppure non è che il Petrotta non abbia posto mano anche a quella che formalmente si suol chiamare opera poetica: anch'egli, come lo Schirò, era sempre all'opera quasi a rincorrere ogni nuova canzoncina religiosa italiana che si diffondesse tra i suoi, per fermarla a tempo, darle bella veste albanese che insieme fosse atta a conservare nella comunità il patrimonio della lingua nazionale, a far gustare la poesia dell'originale, e ad accoppiarsi alla musica oramai acquisita dalla gente.

Decimo anniversario della scomparsa di Papas Gaetano Petrotta



PAPAS PETROTTA, giovane sacerdote.

(PAPA' TANI, meshtar i ri).

Papas Gaetano Petrotta nacque a Piana degli Albanesi (*Hora e Arbreshvet*) il 18 giugno 1882; alunno del Seminario Italo-Albanese di Palermo; ordinato sacerdote nel 1907.

Svolse intensa collaborazione giornalistica dal 1910 al 1915, e poi dal 1918 al 1921, in difesa dell'indipendenza dell'Albania e della integrità territoriale dei suoi confini, sui quotidiani *Giornale di Sicilia* e *Corriere di Sicilia* di Palermo e *Corriere d'Italia* di Roma. Nel 1912 collaborò alla *Rivista dei Balcani*; pubblicò il saggio critico *A proposito di un Catechismo albanese del sec. XVII* e *Cenno storico delle Colonie albanesi di Sicilia e loro condizioni*. Dal 1912 al 1915 principale

collaboratore del Vescovo Mons. Paolo Schirò nel settimanale albanese *Fiala e t'in'Zoti* con apprezzate traduzioni, specialmente del Vecchio Testamento. Nel 1913 laureato in lettere col massimo dei voti all'Università di Palermo con una tesi su *La fonetica comparata della lingua albanese*. Collaborò alla rivista di Grottaferrata *Roma e l'Oriente*; dal 1919 al 1927 alla *Rassegna Italo-Albanese*; nel 1920 alla *Rassegna Italiana di Lingue e Letterature Classiche*; al *Marzocco* di Firenze; nel 1924 il suo *Saggio di Fonetica comparata della lingua albanese* ottenne lode dalla Commissione del concorso per le scienze filologiche dell'Accademia Nazionale dei Lincei; nel 1926 collaborò alle *Cronache italo-albanesi*; dal 1923 al 1937 fece parte del gruppo di « *Tradizione* » dal quale — dopo l'Enciclica « *Rerum Orientalium* » di Pio XI — scaturì il movimento « pro Oriente Cristiano » di Palermo; pubblicò *Il Cattolicesimo nei Balcani - L'Albania*; tenne dotte relazioni in tutte le « *Settimane pro-Oriente Cristiano* » di

Palermo, Siracusa, Venezia, Bari, Firenze e Milano sino al 1940; pubblicò, nel 1930, *La Sicilia e l'Oriente Cristiano*; nel 1931 e 1932 le due edizioni di *Popolo, Lingua e Letteratura albanese* grande volume premiato dalla R. Accademia di Italia; il *Saggio di Bibliografia Albanese*; *Il sentimento religioso e gli Inni sacri di Francesco Crispi*; *il cattolicesimo verso l'Oriente*; *Il fondatore della Glottologia albanese: Demetrio Camarda*.

Nel 1932 inizia in *Rivista Indo-Greco-Italica* la pubblicazione dell'antichissimo Messale albanese del Buzuku (1555); nel 1933 inizia l'insegnamento della lingua e letteratura albanese all'Università di Palermo, che diventa, successivamente, per iniziativa del Governo Regionale Siciliano, insegnamento ordinario. Nel 1938 nominato Canonico della Cattedrale di Piana degli Albanesi. Nel 1940 membro ordinario del R. Istituto di Studi Albanesi di Tirana; membro corrispondente dell'Istituto di Studi Adriatici; dell'Accademia di Scienze, Lettere ed Arti di Palermo; e infine del Consiglio Direttivo del Centro Internazionale di Studi Albanesi di Palermo.

Insegno per lunghi anni nel Seminario Arcivescovile di Palermo e nel Seminario Italo-Albanese; svolse importanti missioni di studio in Albania.

Nel 1943, oltre che titolare di lingua e letteratura albanese, incaricato di grammatica latina e greca e di Filologia bizantina nell'Università di Palermo;

pubblicò *Letteratura albanese ed Italo-Albanese* (1939); *Pio XI e l'Oriente Cristiano*; *Il P. Giorgio Fishta, francescano-Accademico di Italia*; e, negli ultimi anni, *Svolgimento storico della cultura e della Letteratura albanese*; *Poeti siculo-albanesi*; *La Questione etnico-linguistica greco-albanese*; *Valori religiosi e culturali delle Colonie albanesi di Sicilia*.

Mori a Piana degli Albanesi il 30 dicembre 1952.



PAPAS PETROTTA con a destra il Dott. **GIOVANNI SCHIRO'**, e a sinistra il fratello, Dott. **ROSOLINO**.

(PAPA' TANI me Dr. GJON SCHIRO' n'e djathtë dhe të vllán, Dr. ROSOLININ n'e mfaitë)

Ma un altro lavoro tutto suo, dove forse l'opera poetica richiedeva ancor maggiore squisitezza, e fu quello dei testi liturgici tradotti dal greco bizantino in albanese. Anche qui ci voleva dell'ardire. Vero è che già Fan Noli per l'Albania ci aveva posto mano. Ma, canonicamente, la cosa allora era effettivamente arditata, almeno per i cattolici: correva ancora il concetto che ci siano delle lingue liturgiche e delle lingue non liturgiche; appena ora col Concilio Ecumenico attuale siamo giunti in qualche grado a spogliarci di questa mentalità e ad ammettere che ogni nazione possa esser servita liturgicamente nella propria lingua; allora solo pochi, e questi quasi solo tra gli orientalisti, lo pensavano; e si sosteneva, anche autorevolmente, di fronte a un canone funzionale, quale è quello vero che oggi trionfa, un canone storico: non si sa essersi introdotto in alcun rito una lingua nazionale se non a richiesta d'un sovrano di quella nazione; e su tal canone si obiettava non aver l'Albania un sovrano che potesse richiederlo. Papas Petrotta, ciò nonostante, riuscì ad avere un tacito consenso, e si pose all'opera.


Delicatissima è l'opera della traduzione di qualsiasi testo, specialmente d'un testo che presenti una profondità di pensiero congiunta con una ricchezza di coloritura poetica; ed è il caso dei testi liturgici specialmente bizantini: chi non sia teologo, ben difficilmente può riuscire a non falsare il testo; chi non sia poeta ben difficilmente può riuscirvi senza impoverirlo o umiliarlo. E' stato fatto uno studio di confronto fra una traduzione del medesimo testo liturgico, eseguita in toscano da Fan Noli e in siculo-albanese da Papas Petrotta; certo la traduzione Noli non manca dei consueti pregi di vivezza e di sensibilità; ma al confronto, sembra risultare che complessivamente la traduzione Petrotta la superi: certo per maggiore comprensione teologica, ma anche per un pregio speciale stilistico, sul quale occorre intattenerci un istante. E' consaputo che una delle fonti della poeticità è il senso del mistero; è pure consaputo che, nella varietà degli stili, a una composizione sacra, specialmente ufficiale, come quella liturgica, si conviene una certa nobiltà e solennità; tutto ciò poteva essere egregiamente realizzato con quello strumento che il Petrotta si trovava a possedere con piena padronanza: l'arcaico dialetto della sua gente; ora appunto l'arcaismo porta con sè e un senso di mistero e un senso di nobiltà e di solennità incomparabile che il linguaggio quotidiano, quale quello di cui disponeva Fan Noli non può se non raramente raggiungere; non che si tratti del caso, notorio nelle storie letterarie, di stilisti che hanno affettato linguaggio arcaico per accattar prestigio al loro dire; nemmeno d'un parco uso, sempre consentito senza cadere in affettazione, di qualche nobile arcaismo: nel caso delle traduzioni Petrotta, era il linguaggio stesso parlato, ancor vivo, ma arcaico di fonetica, di sintassi e di semantica. Unica opera erudita e quindi unico artificio da parte sua, quello di riassumere qua e là, dove lo esigeva l'impoverimento del linguaggio parlato, qualche dizione o frase antica desunta da vecchi autori, ma subito compresa dal pubblico, tanto da rientrare senz'altro nell'uso; e tanto ben compresa, che il pubblico comune di Piana, non trovando i termini tecnici per esprimere la felicità di questo linguaggio, soleva dire e suol dire tuttora possedere le preghiere di Papas Petrotta una dolcezza che gli altri scrittori albanesi non hanno.

Si viene così alla riprova dell'asserzione che l'opera di conservatore per Papis Petrotta non fu semplicemente di erudito, per quanto appassionato, ma di poeta.

E fu opera di sacerdote. Non occorrerebbe nemmeno ricorrere a quel suo lavoro tipicamente ecclesiastico delle traduzioni sacre, per rendersene conto. Per chi l'ha potuto vedere e conoscere, tutta la sua vita di maestro fu una vita sacerdotale; non una vita in cui il sacerdote si sovrapponesse all'insegnante con l'aggiunta d'alcuni insegnamenti marcatamente religiosi agli altri insegnamenti reputati profani. Come il suo insegnamento era fatto piuttosto di familiare conversazione e consuetudine che non di precettistica, e quindi in lui il maestro era tutto l'uomo con la sua intelligenza e la sua bontà, così era anche il sacerdote con la sua carità e col suo pensiero che dava pregio sacro ad ogni oggetto dei suoi interessamenti.

Dell'opera sua sono rimasti i tesori accumulati nella sua biblioteca, le opere pubblicate e quelle abbozzate; la liturgia e la preghiera in albanese che tuttora si pratica; l'istituzione dell'Eparchia siculo-albanese ora giunta al suo supremo perfezionamento giuridico; e rimangono tutti i suoi alunni e tutti noi che possiamo pure chiamarci tali anche se non siamo stati seduti sui banchi della sua scuola.

Ma questa sua scuola deve continuare ad esser poetica, cioè fattiva. I suoi alunni, i sacerdoti dell'Eparchia, consapevoli della funzione apostolica di essa devono mantenere aperto l'animo e lo spirito all'universalità sia nel pensiero e nel desiderio di servizio all'antica patria albanese, sia nei contatti, per loro singolarmente facilitati, con l'Oriente Cristiano; essi devono amare la liturgia e la sua comprensione; né devono trascurare la funzione tipicamente sacerdotale della conservazione delle preziose tradizioni. Accanto a loro, vestali, nella casa, delle medesime tradizioni, le donne non smentiranno mai le loro migliori qualità che diedero appoggio e possibilità di sviluppo all'opera di Papis Gaetano. Ma tutti i siculo-albanesi dovranno sentirsi in dovere di non tradire la funzione che Iddio ha affidata a queste loro colonie ed ora alla loro Eparchia: finché essi conserveranno le loro tradizioni con una giusta e nobile fierezza, saranno in grado di sentirsi membra preziose e insostituibili della Chiesa Universale e portatori di un valore unico nella società.



Prof. Gaetan Petrotta, letrár e patriot

nga **Karl Gurakuqi**

Shpesh herë m'ásht dhënë rása t'a vizatoj në shtyp fytyrën e ndritun të prof. Gaetan Petrotës dhe çdoherë më duket më i meritueshëm për të qënë kujtue. Më sillen nepër mend fjalët e poetit italian Angelo Gatti, qi thotë se «*la grandezza d'un uomo si misura alla sua scomparsa*». Sot, tue përkujtue dhetëvjeterin e vdekjes, Petrotta më del përpara me të gjitha cilsít e virtytet qi e patën stolisë sá qe gjallë. Më shkon mendja kúr për herën e parë e takova sý për sý; e kishem njoftë edhë má parë, pse i a kishem ndigjue zânin, i a kishem çmue veprimtarín letrare, ishëm në korrespondencë të vijueshme me të; i dërgojshëm nga Tirana çdo botim të ministrís s'arsimit, pse e dijsheëm interesimin e tij për letrat shqiptare.

Në fillimin e vjetit 1937 Shqipnija po përgatitej të kremtonte me shkëlqim të posaçëm njëzet e pesë vjetorin e pamvarsis; nuk u kursye asgjá qi festimet të mbetshin të paharrueshme në kujtesën e Shqiptarvet. Përveç Komisionit qendruer me seli në Tiranë, u krijuen komisione në çdo qendër prefektore, të cilavet i u ngarkue detyra, qi, përveç të tjeravet, të mblidhshin jetëshkrimet e atyne, qi, të gjallë asë të vdekun, kishin dhënë ndihmesën e vet për sendërtimin e ándrrës së Rilindasvet. Ndër këta nuk do të mungonte emni i Gaetan Petrotës, i cili u ftue edhë si mik i qeverís shqiptare për të marrë pjesë n'ato kremtime bashkë me të vëllán e pandashëm dr. Rozolin Petrotën e me dy vëllaznit e Zef Skiroit, dr. Giovanni-n dhe Tommaso-n.

Nuk dola aspak i gënjyer në parashikimet e mija: karakter i qetë, serjoz por buzangáz, i matun në fjalë si banorët e malevet t'ona; ecja e tij e rándë me hap të ngadalshëm të frymzonte nderim, por njiheri edhë afrim; të kishte ánda të bisedojsh me të; nuk jipte gjykime të vrullshme, por gjithmonë të peshueme, aty ku flite njitte. Kishte nji kulturë të gjánë me synime përparimtare, dashuni të thellë për çdogjá shqiptare. I ndiemi ndrýnte në trû të vet nji visár njihunísh, të cilat i pat shti në punë për dobí të Shqipnís e të bashkëvëllazënvet të vet të Sicilís. I urtë: kurr nuk i rrëshqiste goja të mburrej e të krenohej për sá dinte e për sá kishte veprue për përhapjen e kulturës shqiptare me fjalë e me shkrime edhë pranë Shqiptarvet të Shqipnís, ku punimet e tija janë të njoftuna e shum të çmueme. Çdo intelektual njeft dhe çmon veprimtarín e tij të shumanshme në fushën e letravet dhe n'atë të politikës. U shque në këtë të fundit për bashkëpunimin fletorát të frytshëm gjatë vjetvet 1910-1915 në mprojtje të të drejtavet shqiptare dhe në nevojën e nji shteti shqiptár për njipeshimin në Ballkan, për nji Shqipní ethnike. Ishin kohë të vështira, Shqipnija kishte nevojë për miq, zâni i të cilvet të mund të kishte peshë në qarqet diplomatike.

Shtypi ishte arma e Papa Tanit; në shtyllat e tija e foli fjalën e vet, ngrejti zânin, qi ishte jehona e Arbreshvet, në fletoret e përditëshme «*Giornale di Sicilia*» dhe «*Corriere di Sicilia*», ashtu edhe në fletoren «*Corriere d'Italia*». Vëllau i tij, Rozolini, i ruen me kujdes shkrimet e tija, të cilat ká pasë mirsín të na i linte në dispozicion asë të na i lexonte. Prej këtyne shifet afshi dhe dashunija e Papa Tanit për vendin e të Parvet. Nji enthuzjazëm i jashtëzakonshëm përshkohet n'ato shkrime e n'ata artikuj, dokument i gjallë i veprimtarís së palodhëshme të tij e të shokvet t'idealit qi ishte: *Shqipnija e Shqiptarvet të lirë*.

I ndiem i nuk ishte njerí politike, por kúr ishte puna për Shqipni, kúr i cenoheshin të drejtat e mirrej nepër kámbë, çvishej nga petku i priftit, rrokte pendën dhe i a përplaste ndër sý të madhit e të voglit padrejtësin qi báhej në kurriz të popullit shqiptár. Nuk guxonte njerí me ia prekë Shqipnin. Na kanë sigurue t'afërmit e tij, se për të, sikursë për Gjergj Fishtë, në shtratin e vdekjes mendimi i fundit ká qënë Shqipnija, fjalët e mbráme i a pat kushtue Shqipnis. Na qi e kemi njoftë mirë dhe i a kemi çmue ndiesít atdhetare, e besojmë, pá tjetër, se ashtu ká ngjá, se kujtimi i tij n'orët e vdekjes i ást sjellë tokës, për të cilën kishte pasë derdhë djersë sá pat qënë gjallë. Në çaset kúr njeriu e ndien veten se do të ndahet nga kjo jetë, mendja i shkoi te sendi, me të cilin ká pasë má shum lidhje; buzët e tija si në kllapí shqiptojnë fjalë, të përcjelluna me ngashrime, rreth qendrës së dishirevet qi i a kanë mbajtë jetën. E Papa Tani jetonte e punonte për Shqipni.

Por i ndiem i, má shum se kurgjá tjetër, ishte njerí i tryezës, i punimevet mendore, i vëzhgimevet, i hulumtimevet, me nji fjalë, i libravet; mbledhës i zellshëm e botimevet mbí Shqipnin. Shka ást kryevepra e tij «*Popolo Lingua e Letteratura Albanese*» (1932)? Ást lullishta e letërsís shqipe, ku gjindet i përmbledhun i tânë prodhimi i pendavet shqiptare, ást enciklopedija e njohunivet të domosdoshme për të pasë nji mendim të saktë mbí shka ká krijue mendja arbnore qysh prej agimit të letërsís e deri në ditët e tija. Kjo vepër, për kohën kúr ást shkruet, ká qënë përpjekja e parë për t'i falë kombit t'onë dhe të huejvet nji histori, nji burim për të nxjerrë lajme të sigurta mbí traditat letrare të popullit shqiptár. Kjo vepër ká qënë çmue nga shumë anë si nji punë e radhës së parë: Akademija Mbretnore e Italis i dha çmimin e meritimit në letra; Qeverija Shqiptare e dekoroi me Urdhnin e Skandërbeut; shkrimtarë shqiptarë dhe të huej e miratuen me çfaqje admirimi, përlavdimi dhe përgëzimi; miq e dashamirë nga çdo anë e uruen qi të vijojë punimet e veta në ket drejtim. E Papa Tani nuk i gënjeu: mbas botimit të kësaj vepre, veprimtarija e tij në fushën e letravet vijoi gjithnji e frytshme. Në vetin 1932, në bashkëpunim me Emzot Pál Skiroin, filloi në «*Rivista indo-greco-italica*» botimin e Mesharit të Gjon Buzukut, mbí gjuhën e të cilit kishte pasë bá studime të hollësishe, të cilat, fatkeqsisht, kanë mbetë në dorëshkrim, të shpërndame ndër karta e të parregullueme. Thonë se përgjithësisht njerzit e pendës nuk i mbajnë në rregull sendet e veta. Kështu edhe i ndiem i, por në parregullsin e vet s'kishte gjá qi mos të dinte se ku e kishte vù. Karakteri i tij pasqyrohej në shkrimin e dorës, qi e kishte të parregullshëm e pak të lexueshëm.

Në fundin e vjetit 1947 në shtëpinë e Papa Tanit në Pjanë, ku unë gjindeshem si mik, u poq mendimi për të thirrë në Palermë një Kongres Ndërkombtár për Studime Shqiptare. Frymzuesi kryesuer, me këshillet e veta, qe ai vetë, të cilat pastaj u zbatuen nga i vëllai Rozolini dhe nga i nënshkruesi. Dihet se Kongresi u zhvillue prej ditës 24 deri në ditën 26 të tetorit 1948, mbas njëj përgatitjeje së hollësishme, të bame me ndërgegjeje e me vetëdije. Kongresi pat me të vërtetë një jehonë ndërkombtare; ftesavet të kryesis së komitetit organizues i u përgjegjën albanologë nga të gjitha viset e Europës prendimore. Përfundimet e Kongresit i kapërcyen parashikimet t'ona si për interesin që u tregue nga pjesëmarrsit, ashtu edhe për serjozitetin e ndihmesës që çdonjëni i kushtoi mirëvajtjes së tij. Kongresi albanologjik i vjetit 1948 do të mbesë n'analet e kulturës shqiptare edhe për arsyen se qe i pari mbas mbarimit të luftës së dytë botnore, kúr stabiliteti qeveritar nuk kishte ngulë endë mirë rrâjë, kúr çdo nisjativë e tillë kishte rá në gjum, pse gjindja kishte të tjera kokëçamje. Tue marrë para sýsh gjendjen kaotike të Shqipnis fíll mbas luftës, tue vrejte se pendat má të mira u thyen atjë në brigjet e përtejme, organizatorët e Kongresit kanë një meritim të dyfishtë, pse u ngjallë interesi për punët shqiptare në qarqet albanologjike dhe së dyti pse prej këtij Kongresi muer jetë Qendra Ndërkombtare për Studimet Shqiptare, që sot e ká selín e vet n'Institutin e shqipes në Palermë, në fakultetin e letravet t'Universitetit.

Arbreshët e Sicilis kanë tradita të rralla kulturore e patriotike, por, me kalimin e kohës këto erdhën tue u paksue e pak nga pak tue humbë kâmba-kâmbës me zhdukjen e atyne burrave që i patën mbajtë gjallë me vepra gjuhësore-letrare, që as sot nuk e kanë humbë vleftën. Po përmendim në ketë rasë: Lukë Matrangën që përktheu katekizmën e Ledesma-s në vjetin 1592, Zef Skiroin poetin e madh pjanjot me kryeveprën «*Te Dheu i Huaaj*» (1865-1927), Dhimitër Kamardën albanologun në zâ, i njoftun në qarqet albanologjike, Emzot Pál Skiroin filologun e çmuem, të cilit lipset t'i dihet në një farë mënyre përhapja e studimevet buzukjane, prof. Mark La Pjanën studimtarin e hollë të çashtjevet t'ona gjuhësore.

Prof. Gaetan Petrotta bashkë me prof. La Pjanën i dhanë fund veprimtaris prodhimtare në fushën gjuhësore-letrare arbreshe-siciljane. Kjo është arsyeja pse na e qajmë me lotë humbjen e tyne.

Tue e vijue vallimin e botimevet, shofim se në vjetin 1949 Papa Tani boton si ekstrakt të «*Bollettino della Badia Greca di Grottaferata*» (Vol. III) një studim të shkurtë, por rëndësije kryesore për historin fetare-kulturore të klerit arbresh të Sicilis. Æsht ky një shtytje për priftët e sotëm arbreshë për të përpilue një Histori sá má të gjânë në ket drejtim. Lânda nuk mungon: bibliotheka e Seminarit Arbresh të Pjanës duhet të jetë një burim i mirë për ket qellim. sidomos tash që kjo bibliothekë është sistemue në lokalet e reja të Seminarit dhe ká një drejtuer përgjegjës; sigurisht edhe librat e lânun trashigim nga i ndiem Petrotta mund do t'ishin një visár për historin e kishës arbreshe siciljane. Studimi për të cilin jemi tue bisedue ká si titull «*Valori Religjiosi e Culturali delle Colonie albanesi di Sicilia*». Vetë titulli është një program për t'u zhvillue. Njeriu ká mjaft për të thânë e për të shkruie mbí ket argument.

Nji tjetër botim i të ndiemit, qi përmban një program veprimi të mëtejshëm, është vepërza e tij «*La Questione Etnico-Linguistica Greco-Albanese*» (1950). Këmi pasë shkruar edhe një herë tjetër për ket studim. Na pëlqen të radhisim këtu, për hir të historis, disa nga pikat më me rëndësi. Mbrendija e këtij libërthi rreh një çashtje të vjetër, qi herë pas here hidhet në shtyllat e shtypit, t'ashtuqejtunën çashtje të «Epirit të Veriut». Grekët hapin herë pas here një plagë qi ká pasë nisë me vù koje, sherimi i së cilës do të kishte dhënë mundësin e njëj përmirsimi të marrëdhânjevet ndërmyjet dy popujve më të vjetër të gadishullit t'onë. Për të qitë poshtë kërkesat e pa-arsyeshme greke mbi ketë krahinë shqiptare, Petrotta shkroi qysh në vjetin 1941 në Tiranë librin në fjalë, por qi për shkaqe të ndryshme pat ngelë si dorëshkrim. — N'Epir — thotë auktori — flitej qysh prej kohvet më të lashta një gjuhë jo greke, sikursë na dishmon Plutarku në kapitnën e parë të «*Jetës së Pirrit*» kú shkruen se Akili pati «n'Epir nderime hyjnore e se qe përshëndetë në gjuhën e atij vendi, e cila për Grekët ishte gjuhë barbare. Shqiptarsija e «Epirit» mund të shifet, ndër sá të tjera, nga qërthulli i kángvet shqipe historike-epike rreth Ali Pashë Tepelenës. Këto janë pasunija më e madhe e letërsis popullore të Çameris. Duhet të pohohet se të gjitha këto kángë e kanë pasë votrën e vet n'Epir. Nji dokument i rëndësishëm i letërsis popullore çame janë tri kángë popullore shqipe t'Epirit rreth kryengritjes greke (1821-1827), të botueme në përkthimin italisht nga Dhimitër Kamarda. Ky, tue u a paraqitë lexuesvet këto tri kángë, thotë: «*I pochi e nuovi fiori che presento sono germogliati sulle aspre rupi di Suli e Chimara... Chi è che non ha udito suonare glorioso il nome di Suli e in singolare modo dell'eroe Marco Bozzari, il nuovo Leonida non meno degno di ammirazione di quello che fosse l'antico?...*». Albanologu i përmendun Holger Pedersen i Danimarkës në vjetin 1893 mblodhi në Shqipnín e jugut, a sikursë e quen ai Epir, 35 novela dhe afër 250 kángë popullore, gadi të gjitha në të folmen e Çameris.

Petrotta në vjetët e fundit përpara se të vdiste i u vù rregullimit të dorëshkrimevet të veta qi nuk janë të pakta, të cilat, simbas mendimit t'onë, janë ato më të rëndësishmet. I ká mbulue pluhuni, kanë mbetë të vorrueme sikursë ngján, gadi gjithmonë, me veprat qi kërkojnë shpenzime të mëdhaja për t'u vù në shtyp.

Vjeti 1950 ká qënë për Petrotën më prodhimtari në botime. Përveç atyne qi përmendëm më sipër, n'at viet dha në botim një tjetër vepër me titullin «*Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*». Me thánë të drejtën, ky libër është një shkurtore, me përmirsime dhe shtime, të kryeveprës së tij «*Popolo, Lingua...*» Libri rrokë tetë kapitina, po ato qi mund të thohet se janë një gjá e ré, janë prej së katërtës deri në të gjashtën (faqe 131-178), ku, tue ndjekë radhën historike-geografike, zhvillohen më me hollësi se në kryeveprën shenimet letrare. Shofim aty dokumentat gjuhësorë e veprat letrare të shekujvet XV - XVII, ashtu edhe kushtet kulturore të Shqipnís në shekullin XVIII deri në gjymsën e shekullit XIX. Æsht periudha gati-morë, e cila në pjesën më të madhe lipset t'i dihet më së pari veprimtaris së klerit, pjestarët e të cilit kanë meritime të mëdhaja në zhvillimin kulturuer të vendit. Libri mbyllet me një pasqyrë kronologjike auktorësh dhe veprash të këtyne prej më të vjetërvet deri në të sotmit.


Ndonsë me qellime shkollore e pá pretendime, po përmendim edhe blënin «*Poeti Siculo-Albanesi*», një farë antologjije së vogël, një përmbledhje shkrimesh dhe shkrimtarësh, të përgatitun për kursin e posaçëm të letërsisë shqipe në fakultetin e letravet.

Gjithashtu, për qellime shkollore, në bashkëpunim me të nënshkruemin, përktheu n'italisht melodramin e Fishtës «*Jerina asë Mbretnesha e lulevet*» (1).

Në rasën e vdekjes me 30 dhetuer 1952 u botue një blë në kujtim të të ndienit, ku janë përmbledhë çfaqjet e simpatís së dashamirvet e të miqvet me anë artikujsh, shkresash e telegramesh ngushllimi familjes së Petrotajvet. Këtu, gabimisht është botue, në faqen 45, se Petrotta ka bashkëpunue në përpilimin e «*Fjalorit të Përgjithëshëm të Gjuhës Shqipe*» (sic), drejtue nga Prof. Paul Kretschmer (sic), me nisjativën e Akademís së Vjenës (sic). Jemi në gjendje të ndreqim këto pohime të pathemelta. Puna ka rrjedhë këso dore: I nënshkruemi bashkë me prof. Anton Palucën kishin përpilue në vjetin 1946-1947 një Fjaluer shqip-gjermanisht 18.000 fjalësh, në ngarkim t'Akademís së Dijtunivet në Vjenë (shif «*Shëjzat*» Vjeti 1962, nr. 11-12. faqe 382), nënkryetar i së cilës ishte miku prof. Paul Kretschmer. Ky, në marrëveshje me prof. Alois Schmaus, u interesue qi t'i jipej fund atij Fjalori, qi edhe sot ka mbetë në dorëshkrim n'arkivat e Akademís. Gurakuqi i u lut Petrotës qi të radhiteshin në Fjalorin në fjalë glosat e arbrishtes, të mbledhuna nga ai, qi kapshin numrin 800 (tetëqind); i u vùnë përbrí përkatset gjermanishte, u alfabetuen dhe i u dërguen Akademís qi të përmblihdeshin në skedarin e përgjithëshëm.

Çdo vizituesi të Bibljotekës Bashkijake të Palermës, kúr hýnë në sallën e madhe, i del përpara ritrata e Petrotës, qi, bashkë me fytyrat e njerzvet në shëj të Sicílis, rrin aty për të përyjetsue emnin dhe fytyrën e këtij Biri të meritueshëm.

(1) Këtij përkthimi i ka humbë gjurma. Ka qënë shkruar me dorë në radorë shkollë me shenime gjithfarësh. Dorëshkrimi është i emi.



Vjerrsha

nga Vorea Ujko

Unë kam shkuar...

Unë kam shkuar në një fshat
se të ngarkoja trishtimin
e udhëvet me qetësi plot
dhe të shtëpivet pa emër.
Zbritte mjegulla nga kodrat
e bashkohej me tymin
e këlmevet lundruese.
E tufa zogjësh
iknin ndaj bregut të detit.
Burrat mjerkerzes
pushonin të pështjellur në mallota
e po koha kish qëndruar
pa të nesërme.
Në pamje të patundur
lisat ishin krahë skeleti
e dhentë eshtra të zgropësuar.
Vetëm djelmoshat
nuk kishin trishtim.

Mall i herëshëm

Mall i herëshëm...
i fytyrës s'ate lindore
në mugësi të perëndimit:
kishte shije qitrash e trëndafilash.
Tash prapa dritares
zogjit, tue shkundur flatrat,
kërkojnë gjellën
e menjëherë janë borë.
Posi fjalët dhe ëndrrat t'ona:
pakëz erë e lajle ndjenjash
e pastai menjëherë mjegulla.
Ashtu na dhe lisat
e pastai menjëherë mjegulla.
Ashtu na dhe lisat
e gjithësit.
Të fryrë me erë ndaj menatet
e lugata mbrëmanet.

Shpëtim

Te qielli im i llambarisur
zënë e shuhen dritët.
Ndiën timer mbi kurrizë
posi një gur mulliri
edhë kam nër sytë
mergimin e vllëzërvet.
Do t'ikenj përtej fushavet e kohës
e në heshtjen e shurdhër të shkretinës
përbrenda meje — po unë e di —
akoma do të ndiën timer stuhí.
Përgjunj do të pres mbarimin.

Vëllazëri

Në mund'unë të plagosja
me fjalët e mia të gurta,
në mund'edhe të t'thoia
se tej vaut është jeta
e të t'pushtroja këmbët me ferra
sa t'kaptoje i përgjakur misterin!
Kur syt' e tu të gropuar nga nata
do të hapen ndaj erës s'agimit,
ti nuk do të presh më ëndrrën
as do më të nisesesh
o i vogli vëllau im ecëror.

Voreja

O vorë e djalërisë s'ime
miq'e ujqevet dhe greminavet,
verë e jermisë s'ime!
Unë njoh hapin tënd
kur zbret nga shpina malit
për të sulesh mbi shpít'e vjetra.
Pse murmurisë e qesh
posi djalosh që ikë?
Nqule nëpër vorazit e dritsorës
nëpër grykën tumuese e vatrës
e shtërgon rrethimin.
Ngrën ré tymi
e shprish shkëndija
posi tubë lulësh.
Bën tufë kallinjësh ari
e i lëshon të bjen
në hi të hollë yjsh.

Shpritia jote muzikore
 plotëson erën me valle.
 Pra shkundë me rreptësi flatrat
 e fillon bumbullima
 e dufeqëvet tënd.
 Një të ramë daullesh shkreh bëfas
 nga gjishtat magarje plakë.
 Zhurma të shurta e t'përzjeme
 e gremisje t'pakuptueshme
 popullzotë udhët e shkreta.
 E kalojnë hije t'pavizatëshme
 të pështjella me napa të zeza
 tue hedh ninëza
 kurrizësh dhe krerash
 me flokët e shprishur n'erë.
 Zëmra ime e ngurrosur nga fryka
 rrinte posi gjumëzezë
 tue shikuar shkëndijat
 tue ndëqjuar tënd pushtetshem
 që po shpihej nga gjithë anët.
 Për m'e ndajtur shpinë nga bota
 për m'e bën natën më të thellë.
 Çdo gjë nget ndaj triumfit
 me ritmin e këngës s'ate.
 Ti del nga moti i parë
 për me trëmbur kulshedrat
 e hapësiravet polare.
 Ti grisë malet
 e zgjon epshe ikje.
 Lumi it atmosferik
 shëndreron lisat shekullor
 në ngatërrime fijshe të prehtë.
 A po ku janë gjurmat njerzore?
 Toka ime është e vetme
 pa kumbime e pa drejtime.
 Edhë nata ikë
 e shqerrë nga përkrahja jote
 e lë në duartë tënde shtrige
 copa lëkure të zeza
 e tupuj flokësh të murmë
 edhe arkë e turrë
 udhësh të papandehura.
 Ikë nata ndaj diellit.
 Edhe unë ikë me 'të i përzënë
 nga fora jote e marrë.
 Edhe vorë, grua pa zëmër,
 unë jam i burrosur nga ti.
 Unë dua të kthehem djalosh
 për të dreth vallen me tij.
 M'a jep rishtazi ëndrrën?

Pinjulli i fundit i Familjes s'Arjanitasvet [«Das Ende der Arianiten»]

nga **Franz Babinger**

(vijon nga numri 9-10, vjeti 1962).

Çashtja qi do të bisedohej në Këshill kundrohej aq e ngutshme dhe aq me rëndësi sá qi u proponue të thirreshin në Këshillin e të Dhetvet edhe 15 misa të jashtëzakonshëm, natyrisht pá asnji përfundim. Pjesëmarrësit qenë detyrue të ruejshin mësheftësin má të madhe, mos të dilte asnji lajm jashtë. U caktuen edhe emnat e të pranishëmvet. Me 21 fruer u rrah madjë edhe çashtja në se duhej apo jo t'i nñjefej Konstantin Arjanitit dhe pas-ardhësvet të tij për gjithmonë («*in perpetuo*») titulli i fisnikis venedikase. Përveç kësaj, me 19 fruer pat qënë vendosë edhe t'i dërgohej Kryetarit të Bashkis dhe Kapidanit të Rimini-t një shkresë lavdimi për urdhnin e dhánun qi t'arrestohej «*Bernardino de Piamonte Cancellier del Signor Constantin Arniti*» kursë, me 16 fruer, gjindej n'udhëtim për në Gjermani. Kapidani pat marrë urdhnin qi menjihërë t'a dërgonte t'arrestuemin në Venedik. Ishte fjala për një farë *Bernardino di Ambrosi*, edhe ky nga Piemonte, të cilit i kishte pasë qënë besue korrespondenca ndërmjet zolit të tij dhe përfaqsesit papnuer në Romë.

Me 22 fruer pat qënë lajmue ambashadori venedikas në Romë për arrestimin e «*Piamonte-s*» dhe njëjheri pat qënë vendosë të lajmohehshin për ketë gjá edhe ambashadorët francezë në Venedik. I arrestuemin pat qënë marrë nën pyetje të rrebtë, dhe për ketë punë pat qënë mbajtë një proces i hollësishëm, një kopje e të cilit u pat qënë parashtrur për njoftim edhe përfaqsesvet francezë pranë Signoria-s. Arrestimi në Torcello (afër Venedikut, VII, 678) u zgjat disá javë, sá qi me 24 korrik pat qënë vendosë t'i jipej një ndihmë (*sussidio*) për t'i a përmirsue gjendjen e keqe, në të cilën kishte pasë mërrijtë pá kurrnji farë faji. Por, nuk vonoi shumë, dhe Bernardino-ja iku nga burgu dhe aty kah gjyma e dhetorit mërrijti në Romë (VII, 678). Pastaj çashtja mori një pamje qesharake: me 3 mars 1509, d.m.th. mbas plot njëj vjeti, u prenë të gjitha bisedimet mbí atë punë, pse ambashadorët venedikas kishin pasë lajmue prej Rome se «*Comneno*»-ja kishte pasë bá çmos për të prishë miqsin e perandorit me mbretin e Francezvet vetëm për të mirën e Republikës! (Për ketë ngjarje të krahasohet edhe VII, 376 e 678).

Konstantin Arjaniti, përpara se të ndodhte kjo ngjarje, për fat të vet, kishte pasë kthye prap në Romë. Si duket, n'udhëtimin e vet kishte pasë ndjekë një rrugë larg krahinës venedikase, pse *M. S a n u t o* në

«Ditarët» nuk e përmendë aspak kalimin e tij nëpër krahinat e Venedikut Me 9 nëntor 1507 ambasadori venedikas lajmon nga Roma se Konstantin Arjanitisi është paraqitur në Kurje. Sikurse mund të përfundohet nga lajmet e dhënuna, ky ka qënë thirrë me kthye në Romë pse nuk kishte mujtë t'a «tërhiqte» në Itali perandorin Maksimiljan («*per non aver potuto tirar Maximiliano in Italia*»; VII: VII, 179). Porsë «*trama di farlo venir*» (krh. VII. 193).

Në këtë ndërkohë Maksimiljani I kishte merritur në Trento dhe aty me 4 fruer 1508 u kishte kumtue të pranishëmvet në Domin e qytetit me anën e sekretarit të vet të mëparëshëm, ipeshkvit t'asaj kohe në Gurk, *Matthäus Lang Wellenburg* (1468-1540), se kishte pasë pranue titullin e Perandorit romak të zgjedhur nga populli, dhe se sot e mbrapa do t'a barte at titull për *hatër* të Papës e të Selisë së Shëjtë të Romës. Në rasë se *H. Ulman* ka të drejtë kúr pohon (90) se Perandori «menjiherë mbas pranimit të titullit» i ka urdhnuë Kardinalit të Bressanone-s *Melchior*-it dhe Konstantin Arjanitit për t'i a njoftue ngjarjen Julit të II «në mënyrë të përshtatshme», atëherë lipset nxjerrë përfundimi se Konstantin Arjaniti ka lënë përsëri Romën dhe se ka shkue në oborrin perandorak. Kundra këtij pohimi flet lajmi i *oratore*-s romak të Signoria-s qysh në fillim të frorit 1508, i cili thotë se «*cardinal brixinense*» ashtu edhe «*domino Constantino*» qindruen në Romë dhe se atjë e çfaqën mendimin e vet mbi titullin perandorak të Trento-s: Arjaniti ishte i mendimit qi «*qui de proximo cingendus est, videtur accinctus*»; me këto fjale ai donte me thënë se dishrohej kunorzimi i perandorit nga ana e Julit të II në Qytetin e Amshuem, gjâ qi nuk ngjau asnji herë (VII, 297).

Nji muej më vonë *oratore* Sier Giov. *Badoer*, *dotor*, *cavalier* (K.) lajmonte prej Rome se Konstantini gjindej atjë, se krenohej si «*homo dil re e suo orator e commesso*», se bante «*grandissima guerra*» (VII, 335). Papa kishte pasë pranue pã asnji ngurrim vendimin e Trento-s, por është punë e vështirë të pranohet se Konstantini ka mujtë me pasë gisht në këtë punë. Në nji *Breve* të ditës 12 fruer 1508 Papa, tue dhënë pëlqimin e vet, thonte se ishte nevojë e ngutshme të varrihej nji lidhje paqore me Francën, dhe porositte përsëri qi të sëndërtohej udhëtimi i Perandorit në Itali, por pã fuqi ushtarake — simbas shembullit të jatit të tij *Frederikut* të III (91).

Pak kohë mbas këtyne ngjarjeve, në Këshillin e të Dhetvet në Venedik u zhvilluen ato bisedime të gjalla rreth Konstantin Arjanitit, për të cilat folëm më sipër. Æsht për t'u theksue edhe se farefisnija e tij me fisnikin venedikase (këtu është fjala për të dy bijat e nënës së tij me martesë të parë, qi jetojshin aty si grã burrash të përmendun), ashtu edhe lidhjet e tija me *papalistët* kishin rã shum në sý; mjerisht nuk mund të nxiren lajme të hollësishme mbi këtë gjendje ngasë teksti përkatës është fragmentar: ... «*fo cazà li papalista e li parenti dil signor Constantin Arniti, ch'è cossa insolita; et a uno ... ch'è sier Antonio Loredam, è di pregadi, quondam sier Francesco*» (VII, 335 e përtej). Se shka don të thotë fraza «*cossa insolita*», nuk është e kjartë, gjâ qi ka zemrue edhe *M. Sanuto*-n. Sier Antonio Loredan, qi pã dyshim është i shoqi i njënës prej këtyne dy grave, ka pasë gjith jetën e vet nëpunsi me rëndësi dhe shkallë të nalta në Shtetin e Ve-

nedikut: ai pat qënë për një kohë *sopraccomito*, d.m.th. mbikëqyrës i parë i të burgosunvet, pastaj *provveditore al sale*, gjithashtu, por natyrisht vetëm për pak muaj (prej 25 kallënduer 1503 deri në tetuer 1503, krh. Ch. Hopf «*Chroniques*», faqe 393) si *bajloz* në Corfù; në vjetin 1508 ishte *pregad* d.m.th. mis i zgjedhun i Këshillit t'ulët i Republikës së Venedikut (krahaso III, 1335).

Në vjetin 1508 ngjån një tjetër fakt me qellime thjesht familjare, kësaj here në Friuli, dhe që për pak nuk mbaroi keqas. Gjatë vjetit 1506 Princi Friedrich der Weise i Saksonís, të cilit Maksimiljani I, për një uhá (92) prej 65.340 fjorita, i kishte pasë marrë Kështjellat dhe Zotnimet «*Cramaun*» (Cormons), «*Vellgeradt*» (Belgrado) dhe «*Neuburg*» (sot Castelnuovo del Friuli), i a pat lánë Arjanitit nën sundim Kështjellin e Belgradit (2.5 km nga Varmo në Friuli). Por «Duka i Macedonís dhe Konti Konstantin Arniti» (sikursë quhet në pakt) nuk mujti t'a gëzonte këtë pronë, pse Perandori Maksimiljani I me 21 prill 1507 u a kishte pasë lëshue Belgradin dy vëllazënve Friedrich dhe Joahnn von Strassoldo (93) për një shumë prej 5000 duketve ari. Por nuk vonoi shumë e me 11 prill 1508 banorët që ishin shumë të pakënaqun nga pronari, i u shtruen Venedikut, i cili menjherë, të nesërmën, e mori nën zotnim.

Kështjelli i Belgradit gjatë shekujvet ká pasë periudha të ndryshme plot me të paprituna: një herë pat rá në duert e Kontit të mbrám të Gorizia-s, Leonardit, pastaj e s'emtës së tij, Konteshës Katharina Cilli (94), e cila rreth vjetit 1472 i a dorëzoi vëllaut të vet, dhespotit Stepan Branković-it të Serbis, burrit t'Angjelinës Arjaniti, motrës së Konstantinit. Dhespoti që jetonte aty në gjendje të mjerë e që mirrte nga *Signoria* (95) një ndihmë mujore prej 10, má vonë prej 25 duketësh, shikohej me sý të keq nga katundarët e rrethet, pse e kundrojshin si të huej, prandej ndiqej prej tyre derisa má në fund mbylli sýt në Kështjellin e Belgradit (1477). E veja e tij Angjelina vijoi të jetonte në Belgrad me katër fëmijë të vet, por jeta aty i u bá aq e vështirë sá që u shtërngue t'i paraqitej në Vjenë Perandorit Frederikut të III për t'i lypë ndihmë. Pastaj me 9 tetuer 1479 i u dha Kështjelli Weitersfeld (96) në Stirí (Rrethi Mureck; Krahina Radkersburg), në kufi të sotëm të Jugoslovís për t'a përdorë si selí e për t'i nxjerrë frytet; ndërkaq kujdestarija e Kështjellit ndroi zot në verën e vonë të vjetit 1481. Kuptohet prá vetvetiu pse Konstantin Arjaniti e kundronte veten së paku si trashigimtar të zotnimit të Belgradit, me gjithë e motra e tij qysh prej kohe e kishte pasë humbë të drejtën mbí të. Kúr në mojin e marsit Konstantini u pá me gjashtë kuaj në Belgrad, d.m.th. pak javë përpara se *Serenissima*, e zemrueme, pat shti në dorë Belgradin, pat takue në vështirsi, pse kuajt qenë rekvizue me urdhnin e Venedikut dhe i qenë dorëzue «*signor Bortolo*»-s, d.m.th. Bartolomeo-s d'Alviano, dukë i Buchianico-s dhe kont i Manupello-s, *Condottiere* venedikas, i cili thonte se ishin pronë e tij (VII, 410, 427, 428). Por me gjithë këtë, ndonji herë Belgradi shenohet (me 21 prill 1508) si «*locho dil signor Constantin*» (VII, 428; krh. VII 440). Në këtë ditë Sier Giovanni Foscarini nga Pordenone shkruen, se ai simbas ngarkesës së marrun, kishte pasë marrë Belgradin në dorëzim. Këso dore pat marrë fund roli miqsuer friuljan i Arjanitit.

Verën e vjetit 1508 ai e kaloi në Romë. Në fillimin e shtatorit pat qënë hapë fjala se ai ishte përgatitë për t'u nisë për në Gjermani, por, si duket, nisja e tij kishte pasë qënë vonue («*par sia sferdita la sua andata*»; VII, 663). Në māj sigurisht gjindej n'udhëtim përtej Alpevet. Kishte pasë qënë hapë lajmi se ai, i ngarkuem prej Papës, do t'i dorëzonte Perandorit 60.000 duketë; kjo shumë, sikurse shifet në një lajm të māvonshtëm (VIII, 169) pat qënë zbritë në 50.000: «*Item, fo divolgato*» — kështu thotë një lajm nga Rimini —, «*el signor Constantin Arniti per nome di papa andoe in Alemagna, e aver portato al re ducati 60 milia, aziò fazi la guerra contra la Signoria nostra: et prima era orator dil papa in Alemagna el vescovo di l'Aquila*» (VIII, 153). Analisti M. S a n u t o në frazën e fundit shef dërgimin e epishkopit Giovanni da P i a t o, i cili, si duket, ishte një personalitet i çmuem prej tij, qì pat qënë zāvendsue nga «*signor Constantin Arniti*». «*E cussi va il mondo, che il papa manda danari a' christiani, fazi guerra a' christiani*» është një përfundim qì mund të nxiret nga sjellja papnore (VIII, 153).

Përpara se Konstantini të linte Romën, Juli i II thuhet se i pat ngarkue një detyrë delikate, d.m.th. qì t'i bante një vizitë të mështëtë ambashadorit t'atjeshëm venedikas Sebastiano-s Badoer, për t'i njoftue Signoria-s përmbajtjen e Paktit Cambrai (10 dhetur 1508), dhe njikohësisht për t'i proponue qì t'i a kthente mâ në fund Kishës qytetet Faenza e Rimini. Këshilli i të Dhetvet, të cilit diplomati i njoftoi ket kompromis, nuk u denjue t'i jipte përgjegje. Shkaku i mos-përgjegjes nuk qe vetëm sjellja e papajtueshme dhe e egër e Venedikut kundrejt Kurjes, të cilën ambashadori Paolo Pisani (97) përpiquej si e si t'a bante mâ t'ashpër, por edhe ndikesa e disá Patricieve jo shumë të pasun të Republikës së Shën Markut, të cilët dijtën të ndalojshin me çdo mjet rrezikimin e pronavet të veta në Romagna. Lajmi i fillimit të marrëdhënjevet e të bisedimevet ndërmjet Julit të II dhe Serenissima-s, për të cilat na flet vetëm Pietro Bembo në veprën e vet «*Historiae Venetae libri XII*» (Basilea 1567) (98), nuk mund të dishmohet prej asnjij burimi tjetër, por, me gjith ket, nuk mund të dyshohet në vërtetsin e tyne. Konstantini ketë herë veptoi me mendtue i rá përqark kontinentit për të mërrijtë n'Oborrin Perandorak. Duket se ai ká zgjedhë rrugën e detit në qoftë se mund t'i besohet lajmit qì të dy ambashadorët venedikas Pisani dhe Badoer-i patën dërgue në Venedik nga Roma me 27-29 prill 1509: «*Item, il signor Constantin Arniti torna per mar al re di romani, e li porta 50 milia*» (VIII, 169). Me 27 prill 1509 qe shpallë «*Shkishnimi i Madh*» dhe pak javë mâ vonë ngjau e thyemja e Agnadello-s, e cila shkaktoi një kthim përfundimtár në marrëdhënjet ndërmjet Serenissima-s dhe Selís së Shëjtë. Këso dore qe vulosë edhe fati i qytetevet romanjole.

Konstantini mendoj edhe një herë se i kishte ardhë koha për veprim, dhe i la në njënë anë masat diplomatike. Në fundin e qershorit të vjetit 1509 një Zbulues («*explorator*») i kumtonte Signoria-s nga Milani: «*E a Vicenza è Frachasso* (d.m.th. Konti Roberto Sanseseverino) e il signor Constantin Arniti, orator dil papa, e altri, aspetano il re di romani dia vegnir li» (VIII, 501). Me 18 korrik Konstantini

gjindej në fushimin perandorak Marostica («*Marostega*»), jo shumë larg nga qyteti Vicenza bashkë me Padovanin «*collaterale*» (si me thënë Komisar Luftë) «*Cao di Vacha*», d.m.th. Antonio Capodivaca; si duket, edhe një herë i ngarkuem nga Perandori me një detyrë ushtarake (VIII, 528, IX, 46). Ai komandonte një grup papnuer prej 300 vetësh, i cili bënte pjesë në ushtrinë perandorake: «... 300 *dil papa, soto il signor C.A., ch'è capitano dil re*» (VIII, 545); duket se selija e tij më të shumtën e herës ka qënë në Vicenza, ku pak kohë përpara Papa Juli i II kishte pasë emnue si epishkop të birin e motrës së tij Maria, Franceschetto della Rovere («*et Vicenza dete al nepote dil signor Constantin Arniti*» (VIII, 556; krh. edhe VIII, 410).

Kjo ushtri kishte qënë përgatitë për ndërmarren kundra Padovës, e cila, si duket, kishte fillue të mirrte njiarë rëndësije. Konstantini ishte krenar për këtë detyrë dhe për veprimtarinë e zhvillueme prej tij, kaq sa me 17 gusht 1509 njoftonte me krenari e vetëlavdim (IX, 46 e 67), se, në rasë se Padovanasit nuk do të dorëzoheshin, ai do t'i vriste të gjithë pa përjashtim. Signoria, kështu pat njoftue, se do të kishte veprue më me mend po t'ishte bashkue me të mirë me Perandorin: «*Quelli di Padoa non si vol render? Li amazeremo tutti... Saria stà mejo la Signoria si havesse pacifichà con questo re*» (IX, 67). Ndërmjet ushtarvet të radhitun përpara qytetit Padova qënë dërgue edhe 450 kalorës italianë, të cilët ishin nën komandën e «*signor Constantin et suo nipote*». Gjithashtu marrim vesht nga e njajta listë se në të njajtin grup ushtarak bënte pjesë edhe «*Mercurio Bua, con un altro capo stratioti*» (IX, 102) (99).

Përkthen nga gjermanishtja: KARL GURAKUQI

(90) Krh. H. Ulmann «*Kaiser Maximilian I.*», II (Stuttgart 1891), faqe 340.

(91) Në Breve - ne 12 frorit 1508; krahaso H. Ulmann, II, faqe 340.

(92) Mbi «*Le vicende del castello di Belgrado sul finire del medio evo (sec. XV)*» me 29 maj 1959 kam mbajtë në sallën e Pallatit Bashkijak n'Udine një konferencë përpara Akademisë së Dijtunivet, të Letravet e t'Artevet të Friulit (kjo konferencë nuk është botue ende). I jam mirënjohës drejtorit t'arkivit krahinuer në Weimar, Dr. Hans Eberhardt-it, i cili m'a bëni të mundun shqyrtimin e fatevet të ndërlikueme të Kështjellit të Belgradit në fillimin e shekullit XVI.

(93) Krahaso traktatin t'em «*Kaiser Maximilians I. geheime Praktiken mit den Osmanen (1510/11)*». Me dy fytyra, në *Südost-Forschungen*, XV (München 1956), faqe 201-236, ku është botue edhe një pamje e vjetër e Kështjellit të Belgradit, qi sot është zhdukë pa lënë asnjë gjurmë.

(94) Të krahasohen traktatet e mërzitëshme, në të cilat bënë pjesë edhe Sulltan Mehmedi II personalisht me dërgimin e njëj çifuti të quejtun Simon (krh. Cronaca të Stefano Magni-t në C. Sathas «*Documents*», IX [Paris 1890], faqe 222, ashtu edhe N. Jorga «*Geschichte des Osmanischen Reiches*», blë II, faqe 204). Gjith këtyne Ludwig v. Thallöczy u ka kushtue një përshtkrim të hollësishëm dhe të rëndësishëm në «*Wissenschaftlichen Mitteilungen aus Bosnien und der Hercegovina*», III (Wien 1895), faqe 344. Aktet e mbledhuna nga Thallöczy mbi këtë ngjarje gjinden në kopje të lidhuna

mirë e pastër si dhuratë e auktorit në Biblioteca Comunale Vincenzo Joppi në Udine, të cilat unë shpesh herë i kam përdorë për qellimet e mia.

(95) Ai pat gradën e Patricit Venedikas qysh prej dhjetorit 1435.

(96) Krh. Jireček «*Geschichte der Serben*» II/1 (Gotha 1918), f. 245 gabimisht kujton se është fjala për «Kështjellin Weitensfeld pranë qytetit ipeshkëvnuer Gurk në Karinci».

(97) Paraqitja krenare në Kurje, për të cilën na jep dokumenta të mjaftueshëm Ludwig v. Pastor «*Geschichte der Päpste*» III/2 (1924), faqe 761, ka idhnue Pietro Bembo-n, i cili e tregon si «*morosi admodum ingenii*» (Hist. Ven. libri XII Basileae 1567, f. 299). Ai qe «*molto colerico*» (krh. L. v. Pastor vepër e përmendun III/2, f. 761, shenimi 1). «*Dispacci-t*» e tija i ka botue Rob. Cessi. Aty flitet natyrisht gjatë mbi K. A. dhe dërgimin e tij.

(98) Vepër e përmendun, faqe 298 dhe L. v. Pastor, vepër e përmendun III/2, faqe 760.

(99) Mbi Mercurio Bua, i cili u dallue si komandant kalorësh të Perandorit dhe qi në vjetin 1510 u emnue kont, gjinden shum lajme në «*Ditarët*» e M. Sanutos. Mbi «*Familjen e Bue Shpatës*» të krahasonhet Ch. Hopf «*Chroniques gréco-romanes*» (1873); faqe 531. Kjo familje ishte ndër më të përmendunat e fisevet shqiptare dhe ishte farefisnue edhe me familje fisnike dalmatine. Pronat e saja kryesore gjindeshin në Shqipërin jugore dhe në Epir (Angelokastron, Joannina, Lepanto, etj.), por disa misa të familjes e shpërngulën veprimtarin e vet ushtarake sidomos në Moré, ku për shembull Pjetër Bue Shpata mbahej si kryetar i Shqiptarvet t'atjeshëm (1453-1498 simbas Hopf-it). Njëni prej pas ardhësve të saj duhet të ketë qënë Mercurio .Asë Maurizio? simbas Hopf-it), të cilin fati e kishte pasë hjedhë në Itali. Si duket, martesë e tij në vjetin 1519 me të motrën e Konstantin Arjanitit ka qënë pa fëmij. Simbas gjase, ai ka vdeke «mbas vjetit 1527» (Hopf, 531).

GOJA E POPULLIT

Kur martoj plaka të birin e i erdh nusja mbë kâl tu shpija, tha:

«E lumja unë, m'erdh prâja!»

«Mos zdrypsha shëndosh prej kësaj pele, në gjeç prâjë prej meje!» per-gjegji nusja.



- a) Kallu zjarm kapullâ!
Na kemi shum gjâ:
Shum dhen e shum dhî,
Treqind kosha me tagji.
- b) Kallu zjarm të pjekim lardh,
Lardh Gjobardhi
Bukë koshari
Venë Mirdite
Djathë Sellite.

(Nga përmbledhja e Prof. Anton Paluca)



LIN DELIJA: Zoje shkodrane në kostum.
(Signora in costume scutarino).



LIN DELIJA: Nuse shkodrane qi kthen me vizitue prindët.
(Sposa scutarina in visita dai propri genitori).



LIN DELIJA: Dyluftim ne Malsi.
(Duello fra montanari).

Le poesie del Vescovo Giovanni MELE

di Giuseppe Gradilone

E' per me un piacere presentare ai lettori di *Shêjzat* la raccolta di poesie di S.E. il Vescovo Giovanni Mele (G. Mele - *Poesie* - Patitucci, Castrovillari, 1962): un piacere che ha la sua origine nel ricordo, vivo sin dagli anni della fanciullezza nel mio cuore, della ieratica, cara immagine del Pastore di anime.

Per chi non fosse al corrente è bene ricordare che S.E. Giovanni Mele è il Vescovo dell'unica Diocesi autonoma di Rito Orientale in Italia, di quel rito che i profughi Albanesi portarono nella terra ospitale e difesero e custodirono gelosamente. La sede è Lungro, una delle comunità albanesi della Calabria.

E' sufficiente dare un rapido sguardo all'indice del volume per farsi una idea della varietà dei temi svolti. Ben sei sono le sezioni in cui si articola la raccolta. Essa è aperta dai sonetti, in cui sono o condannati i vizi o esaltate le opposte virtù umane. Seguono i canti ispirati dalla guerra, che, pervasi di orrore per tale flagello, sono disposti secondo una spirale di progrèssione spirituale; di poi quelli che trattano il motivo della famiglia, che diventa sacro alla luce della fede cristiana. (Si parte dal presupposto che essa sarà tanto più bella quanto più piena è stata l'educazine spirituale dei coniugi). La quarta parte comprende gli inni sacri, che non potevano mancare nell'opera di un Uomo di chiesa, la quinta dei semplici e delicati colloqui con i diversi elementi della natura (l'ulivo, il sole, la luce ecc.), la sesta argomenti vari.

Non è questa la sede adatta per fare un'analisi particolareggiata e approfondita dell'opera, perchè si supererebbero i limiti di una presentazione. Accenno a qualcuna delle tante considerazioni, che la sua lettura suggerisce. Anzitutto è bene sottolineare la padronanza della tecnica, che l'Autore rivela, cioè la conoscenza dei vari metri che usa con disinvolta naturalezza: è questa una prova della sua passione per le letture, come egli stesso ci attesta: «*Ahi quante d'imparar brame contenni!*». (Soliloquio pag. 196). Senza dubbio nobili sono l'intento e la ispirazione, di rendere cioè migliore il lettore: «*Odio il molto parlar con poco sugo; / scriver solo per scrivere non voglio; / voglio, scrivendo, dir quel che più preme*». (Soliloquio).

Mi si potrebbe obiettare che questa non è la funzione della poesia; ma non è difficile indicare, facendo un rapido excursus attraverso i secoli, che il genere didascalico è sempre stato coltivato ed ha dato spesso felici esiti poetici, in quanto ogni materia può essere sorgente viva di canto. Perciò anche in questo caso non mancano immagini limpide e felici.

Nella «neve» c'è il trepido quadro dei fanciulli lieti per la neve che «scende dolcemente»: «*tu porti molta gioia ai fanciulletti, / che s'incantano vedendoti venire / a guisa di miriadi di farfalle,*» / e quello non meno efficace dei contadini, che vedono il fenomeno sotto un altro aspetto, intravedendo i benefici effetti di esso: «*che van pensando che da te protetto, / il grano lungo i solchi si prepara / a trasformarsi in verdeggianti steli, / che poi daranno la spiga dorata,* /».

Nella «Spiga» si succedono bei quadretti, che mettono in risalto lo spirito di minuta osservazione. da cui traggono origine: «*i manelli alle biche le donzelle / sopra le spalle portano cantando / o sopra il capo baldanzose e snelle. / I bimbi all'aia vanno ruzzolando, / persistente è il frinir delle cicale, / insetti in alto ovunque van ronzando. / Dalla zampogna al dolce suono eguale / vengon battuti i covoni sull'aia / o premuti da pietra tonda o ovale. / Nello avanzarsi della notte abbaia / il can da guardia e il dolce sonno chiude / gli occhi a ciascuno fin che l'alba appaia*». / Come non accennare all'esaltazione che fa della parola nella poesia omonima o al senso di gioioso stupore che genera nel Poeta lo spettacolo immenso del cielo stellato? (cfr. Le stelle). Ogni motivo, però, ogni osservazione sono lievitati dalla Fede, da quella Fede di cui il Nostro è umile, ma degno Ministro: «*Nel concento mirabile del mondo / gli occhi chino del corpo e della mente / e Te profondamente amo ed adoro*». (Cfr. Le stelle).

Nel chiudere queste brevi note mi auguro che l'insigne Autore in seguito si serva come mezzo espressivo anche della lingua Albanese, tanto più che Egli ha già dato prova di perizia nel suo idioma natio.

GOJA E POPULLIT

**Ma mirë kuq në fëtyrë,
Se zî në zemër!**

(Ma mirë turpnou me ndokend se
sá të pësojsh ndoji dam!)

**Shtat e hije,
Mend as nji fije!**

**Shtatin fyell
Menden pyllë.**

**S'ká peshk pá halë,
As shpí pá fjalë.**

Rá fyti e na mbyti.

**Dimni strukë delijt,
Verazderhallë majmunat.**

(deli = burr i fortë)

(Nga përmbledhja e Prof. Anton Paluca)

Dy pamje nga historia krahinore e Shqiprisë

nga Ekrem Vlora

(vijon nga nr. 11-12, vjeti 1962)

P j e s a e I I

Sjellje poshtruëse.

Në pjesën e parë të këtij tregimi (1) kemi përshkruar sjelljet trimrore, vrasjet, presjet e rrenimet pa asnjë dobië lëndore, bërë vetëm e vetëm për të kënaqur krenarinë vetjake dhe për të shpurë në vënd urdhnesat e zakonit. Këto sjellje provojnë se sa rëndësi i ka dhënë Shqiptari në kohën, kurse ndjenjat edhe parimet e burrnisë sundonin ende shpirtin e tij, nderit, burrnisë edhe ahmarrjes, — shkurt disa parimeve trashgimore.

Mjerisht edhe më at'kohë janë çfaqur përjashtime në këtë rregullën e përgjithshme. Janë bërë disa shëmtime që na vënë në dyshim mbi veçunjtë bujare të kombit t'onë; sjellje poshtruëse që habitin shumë herë ata që nuk kanë thelluar shqyrtimin e zhvillimit të vetijave Shqiptare edhe të rrethanave që i kanë shkaktuar.

Pikë së pari nuk kemi të drejtë të gjithsojmë më një popull as cilsit as veset që na paraqiten në raste të ndryshëm. Mbasandaj duhet t'a dallojmë, nëse mendimi botnor i atij populli i pëlqen ose i qorton këto sjellje poshtruëse.

Unë jam i bindur që sjelljet këso dore — edhe nëse i kanë siguruar veprueësit një përfitim — jo vetëm nuk janë pëlqyerë ndër Shqiptarët, por janë përmëndur brez mbas brezi si një ngjollë turpuëse për atë që i ka bërë edhe për far'ë fisin e tij. Ndërsa sjelljeve trimrore, burrnore Shqiptari u ka ngrehur këngë lavdruese edhe kryesisht e tyre i ka vënë në radhën e heronjve. Për t'a provuar këtë, mjafton të përmëndim këtu Zejnel Gjonlekën, Ali Pash Drenin (Kryezi), Xhin'e Fajës edhe shumë të tjerë, që pa asnjë përfitim vetjak janë bërë fli për të lartësuar nderin, besnikrinë, mikpritjen — shkurt, ligjin e zakoneve trashgimore.

Ka, pa dyshim në radhën e atyre që përmënden në tregimet popullore në këngët, edhe njerz të dobët; njerz që janë bërë viktimat e ndjenjavet tyre, viktimat e rrethanave; sidokudo në botë. Por prova më e mirë që sjelljet e tyre nuk kanë hasur më asnjë pëlqim, është

(1) Shif: « *Shëzjat* », nr. 11-12, Nanduer-Dhetuer 1962, Vjeti VI, f.376-380.

fakti që edhe sot, mbas shumë e shumë vjetër që kanë kaluar që nga dita e ngjarjes, përmenden me urrejtje.

Gojthanja popullore (edhe pjesërisht historija) na thonë:

Më 1810 fuqija sunduese e Ali Pash Tepelenës ish përhapur edhe në Sanxhakun e Vlorës, mbasi u mënjana Ibrahim Pash Vlora, tue u shpër më para në Konicë edhe mbasandaj me gjith familjen e vet (të shoqen e të birin), në burgun e Kalas të Janinës. Në mbarim të vitit 1811 Ali Pasha ndjeu nevojën të dërgojë në Vlorë një përfaqësues. Zgjodhi për këtë detyrë Kudhësiotin Velo Harizin edhe e emnoi « *Mytesel-lim* ».

Velo Harizi ish një burr i matur, i qut, por edhe guximtar. I ati i Hariz Agajt ish vëndosur në Sevaster edhe kish gëzuar në gjallje një konsideratë të përgjithshme. Por të birit nuk i kish lënë as pasunë as edhe ndonjë pozitë të themeluar. Velo u detyrua pra t'i kërkoj të dyja në kurbet, e në mjeshtinë e armvet. Më 1805 kish hyrë në shërbimin e Ali Pashës. Veprimtaria luftarake e Pashajt tërhiqte, më at'kohë, mijra të rinj « *Ylefexhinj* » (2) në rrethin e saj. Të rinj, që kërkonin famë e fitim në ndërmarrjet ushtarake. Në pak kohë e sipër Velo u çqau ndërmjet shokve. U emnuua kryetar çete. Ali Pasha e afro; ja pëlqeu sjelljet edhe e besoi. Kur filloj më 1808 të nxiste popullin e Sanxhakut Vlorës kundra Ibrahim Pashës, përdori në këtë punë në radhën e parë Velo Harizin. Në Vlorë, Velo u lidh me « besa-besë » me një njeri jashtzakonisht të çkathët në kësodore punë: me Hoxh Manen nga Sevasteri. Hoxhës i shkante fjala ndërmjet bashkkatundarvet tija; dinte mirë t'i bindte njerzit; ish i qut, ngatresamath edhe kish zotsinë t'a shtinte ç'do intrigë në formën e një fjalës ose një veprimtarisë të paanshme. Ish drejt vet — thonë edhe sot katundarët, kur tregojnë djallzit e tija.

Mirë po kish një të mbetë: « nuk duronte dot as edhe hijen e kurrkujt mbi kryen e vet ».

Më 1809 ra një zë e madhe në krahinat e Vlorës. Nga shirat e pareshtur nuk u bë misri; nga të ftohit ngordhi një shumicë e madhe e bagtisë. Njerzija, sidomos në luginën e Lumit-Vlorës, po vdiste për bukë. Velo Harizi i shoqruar nga Hoxh Manja, shkoi në Janinë, i shpjegoi Pashajt që rasti më i volitshëm për të fituar antarë në Vlorë ishte ky. Ali Pasha dërgoj dhjet karvanë me misër, si edhe ndihma të tjera. Velo edhe Hoxha i përndanë këto nëpër njerzit që mund t'ju hynin në punë për misjonin që po kryenin në Vlorë.

Veprimtaria e parë e Velo Harizit kur mori në dorë zyrtarisht qeverrimin e Vlorës, ka qënë të detyrojë të dy niprit e Ibrahim Pashës, Ismail Ben edhe Beqir Ben, të arratisen e të shkojnë në Stamboll. Të dy Bejlerët e rinj (si mbas zakonisht të parisë Shqiptare), kishin shkuar keq me ungjin e tyre Ibrahim Pashën. Bile Ali Pasha ish munduar t'i përdorte kundra atij, por nuk mundi t'i hedhë në dorë. Kur u zu Ibrahim Pasha, të niprit e lartpërmëndur qindruan të paanshëm edhe kujtuan që me këtë mënyrë do jetonin të qet në Vlorë. U gabuan! Më 1812 Velo Harizi mori urdhër t'i kapë; mezi shpëtuan. Mbas kësajja i erdhi radha disa burrave nga parijsja e Vlorës. Në qytet kapën dy nga

(2) *Ylefe*: rrogë, pra rrogat.

dera e Xhyrejve, një nga Mezinajt, një nga Kokoshajt; në Kaninë Osman Aga Bimon. Të tjerë nga Dukati, nga Mavrova, nga Tërbaçi. Shumica e tyre u dërgua në kalan e Prevezës. Në Risili u bë një përpjekje mjaft e fort kur deshën të zënë Omer be Risilinë, (3) por fuqit e Velo Harizit ishin më të forta. Pushtuan konaket që kishin Risiliët mbë «Sheshin e Spahiut», i dogjën, i plaçkitën (4) edhe Omer benë me gjith far'e fisin e tij e dërguan në Lluros.

Kështu Velo Harizi i siguroi vëndit qetsinë, Ali Pashës sundimin edhe vehtes tij pasuninë edhe influencë të pakufizuar. Tre vjet me radhë mbretroj në krahinën e Vlorës, por harroj ndër këto rrethana «miqët e vjetër».

Mirë po, Hoxh Manja nuk flinte. Ai ish një «sportist'i kundërshtimit». E ndjente për detyrë të matesh edhe me Velo Harizin dhe t'i «tregonte *hadîn*» (5). Dikur Hoxha kish kundërshtuar edhe Ibrahim Pashën, që ish «Oxhaku i vëndit»; jo se p'se i kish mënië, jo se p'se kërkonte famë edhe fitim në këtë ndeshje, por se p'se «ish mërzhitur nga nami që kish fituar Pashaj; ish bezdisur nga lëvdatat që bënë njerzit për sundimtarin e vëndit». Me Pashan s'kish asnjë armiqsië; përkundrazi kish detyra mirnjojtjeje, — i kish parë të mirën. Hoxha nuk dilte kurr në sheshin e ndeshjevet që bënte. nuk merrte pjesë në veprimtarira luftarake, gjaksore, qindronte gjithmon më një anë, «hidhte gurin edhe fshihte dorën». «Trimrija është një nga shënjat e marrisë» thosh përhera.

Dhe këtë herë, po ashtu bëri. Vendosi mirë e mirë që t'i hante kokën Velo Harizit: se p'se kishh harruar «mikun e vjetër»; se p'se nuk e «sajdiste» më; se p'se nuk e pyeste, nuk i jepte rëndësië! Mendoj një pllan djallzor!

U nis për në Janinë. Atje zbriti në shtëpinë e mikut tij, Abas Ag Dragotit, që ish një nga besnikët më të afërt të Ali Pashës. Abas Agës i tregoj, me fjalë të urta, me arsytetime bindse, me prova, rrezikun që paraqiste qindrimi i Velos në Vlorë edhe i premtoi që gjith këto ish gati t'ja thosh Pashajt po qe se Abas Aga e takonte me të. Abas Aga nuk e donte Velo Harizin. Disa ngjarje të vjetra, e sidomos pozita që kish fituar rishtazi ja kishin nderuar nakarin edhe armiqsinë. Ndërmjetsoi për anë Pashajt, edhe ky e priti Hoxh Manen. «E si venë punët në Vlorë, or Hoxh, si e shkoni me Velon?» e pyeti Ali Pasha. «Mirë or Pasha tungjat-jeta. Fare mirë jemi në saje të Velo Harizit. Ai mbretroon në Vlorë edhe neve e brohorisim, se atë kemi nënë e babë!» Pashaj u çudit! P'se kish ardhur ky hoxha që nga Vlora? Mos, për të lartësuar Velo Harizin, një shërbëtorin e tij e për të paksuar rëndësinë e të zotit? Vazhdoi të pyesi: «Po për mua çar thonë Vlonja-

(3) Që më 1803 e deri më 1809 ky ka qënë «Myteselim'i» Ibrahim Pashës në Vlorë.

(4) Edhe sot në shtëpin'e Harizajve shifen hekurat e dritorevet të mara nga konaket e Risiljotve.

(5) *Had* (fjalë arab.: *atë që i përket*). Shprehja përdoret kudo në Shqiprië; është një përkëthim nga turqishtja. Më një form tjetër, po me atë kuptim, thonë në Vlorë «*t'i rrëfej se sa i bën likura*».

tët? » «E kush ta di e ta përmënd ty emnin or Pasha, sa që sundon Velo në Vlorë», u përgjegj hoxha. Ali Pasha u mërzit edhe i dha udhë Hoxh Manes. Jasht, Abas Aga e qortoj: «Ç'ishin ato fjalë që the, mor Hoxh. Ky ish premtimi që më bëre?» «Rri or Abas» ja priti Hoxh Manja, «ku di ti nga këto punë. Në takimin e parë unë kishja nevojë «t'i shtija Pashajt mizën në vesh». Pas kësaj brumbullon vet ajo!» Abas Agën e këshilloj t'i thot Pashajt që të japi urdhër «të mblidhen në Vlorë ndihmat që dikur kish përndarë Pashaj me anë të Velo Harizit, se ato «nuk ishin një dhuratë por një hua!» Me këtë këshill tregohemi si besnikët e Pashajt edhe Velo Harizit ja thyejm zverkun!» komentoj hoxha.

Pas pak dit dolli urdhri të mblidhen ndihmat në fjalë. Hoxh Manja e mori vesh, vrapoi në Vlorë. Me të mërritur përhap fjalën që Ali Pasha «ja kish falur Velo Harizit ndihmat që dikur kish përndarë edhe e kish lënë të lirë t'i mblidhte ose t'i dhuronte».

Kjo çpifja bëri në Krahinat e Vlorës përshtypjen e plasjes të një bombës. Velo Harizi u çqetsua fort. Thirri me një herë parin'e popullit më një mbledhje te «Rrap'i Lelos» në Sevaster, për t'i shpjeguar se si qindronte e vërteta e punës. Mirë po Hoxha e kish paraparë edhe këtë. Përshpëriste në vesh të miqvet tij, edhe të «syleshave»: «Mos besoni se ç'do ju thot Velo. Unë po vinj nga Janina. E kam digjuar me veshët e mij nga goja e Pashajt. Ali Pasha ka gjetur belan nga Velo Harizi. Nuk do të ngjalli një çeshtje me pushimin e tij, s'ka edhe si t'ja mohojë kërkesat e ditaditshme që i bënë. Është fort i mërzitur. Kush do t'i bëjë një shërbim e të fitojë mirënjajtjen e tij, por njëkohësisht të shpëtojë edhe «miletin» nga belaja e këtyre ndihmavet, le t'i futi një kobure Velos, të mbyllet ky "sherr"! ».

Disa djem të ndezur, që ishin njëkohësisht edhe debitorë të fortë, vendosën të zbatojn këshillat e Hoxhës. Në kuvëndin që u mbledh nën Rrapin e Lelos bisedimet edhe akuzat u ashpruan. Një djal'i përhedhur, Ormën Dashi, i bindur se po i bënte një shërbim vëndit, u ngrit, shtiu dy kobure mbi Velo Harizin edhe e vrau!

Kënga popullore na thotë:

«Rrap'i Lelos, dega tënd!

O Harriz, o Vezir,

Se ç'po mbahe me pahir.

Ormën Dashi, bir o bir!

Po të ndjek pa mëshirë.

Fjal'e drejt, po e vështirë

Nuk digjohet nga të pirë!».

Me të rënë Velo për tokë, u çfaq reaksjoni më një mënyrë të egër. Miq dhe armiq morën anën e të vrrarit. «Qysh — thosh gjindja — guxon dikush të preki «besën e kuvëndit?» Ndërkohë Ormën Dashi u arratis.

Por Hoxha u bë tash udhëheqsi i atyre që kërkonin dënimin e tij.

«Vrajani qënin e qënit.

Vareni në deg të mënit!

Se na vrau Ajan'e vëndit »,

këndon kënga popullore.

Hoxh Manja shkoi në Janinë në krye të një komisjoni që kërkoi nga Ali Pasha kapjen edhe vrasjen e fajtorit; edhe me të marrë lejen u këthye edhe e mori në dorë zbatimin e këtij vendimi.

Ormën Dashi, bashk me dy shok u varën në degat e Rrapit Lelos!

I qet, i kënaqur edhe «faqebardh», se p'se vrau «Ajan'e vëndit», Hoxha u tërhoq prap në jetën e tij private edhe gadal nga dale u harrua! Por sot, pas 150 vjet përmëndet me urrejtje kujtim'i tij!

GOJA E POPULLIT

Qerrja bajë, luga daj. (Tiranë)



Mallë n'arkët e dreq në barkët. (Tiranë)



Punò fatkeq, e ha bark-dreq!



E din luga çka ká vegshi.



Mos i besò: Grues qi qanë, kalit qi
djerset e burrit qi bân bé!



Me çakrra e makrra. (Mit Sack und Paek)



S'ká shka i bân kalit, e i bjen samarit.



Me një lule s'del prendvera.

(Nga përmbledhja e Prof. Anton Paluca)

Skjarime rreth Xanonit

nga Zef Valentini S. J.

Jup Kastrati përsëri — e ketë herë pá lânë, po thuej, gjâ mangut — mirret me Xanonin me një monografi qi meriton çdo laud (1). e prandej edhe një përgjegje pyetjevet qi bân.

Çuditet Jupi së pari pse e shumta e vepravet të pabotueme të Jezuitit meritimplotë nuk u botuen sëpaku mbas vdekjes së tij, ndonsë, mbas gjith gjase, ruheshin të gjitha me kujdes prej sivëllazënvet n'arkivin e bibliotekës saverjane.

Jezuitët qi kishin mujtë me u kujdesë për një botim të tillë, kanë kënë mâ se një. Për të tjerët, mbasi jam plakë e shumë kujtime shkojnë tue më dalë mendjeje, s'po dij çka të thom: ndoshta s'kanë mendue se librat mund të shiteshin... e nuk duhet të besohet se Shtypshkroja e së Papëryemes ká pasë kapitale; jetonte prej njëj dite në të tjetrën; për një kërkues të hollë si J. K. mund të jetë interesant me dijtë se të hÿmet e saja mâ të forta nuk ishin as prej vepravet letrare shkencore, as prej tekstavet shkollorë, qi kishin sukses kÿr barasojshin të dalunat, por prej... kalendarit muejuer me parashikime të motit të P. Frakjonit! Këtë mund t'a dij unë, qi e drejtova shtypshkrojnë — tue mbushë të shpraztat e saja herë mbas here me akrobacina — ndër dhetë vjetët e fundit.

Sá për vedi, nuk kam pasë ndonji arsye për mos me i botue ato vepra. posë se për Xanonin ajo nuk ishte koha. Koha kÿr punonte Xanoni ishte një kohë e thjeshtë, kulturisht e letrarisht pá mtesa (esigenze) (të mendohet se ndër punime të vetë Xanonit, ato qi patën sukses mâ të madh kjenë përkthime auktorësh qind për qind popullorë, si kanoniku Schmidt!); epoka qi u end pothuej fill mbas vdekjes së Xanonit, kje përkundra një epokë ambicionesh kulturore të pá kufij, një epokë kÿr mund të pelqehet Mjedja mâ i nalti e jo Xanoni.

Shkrimtarët si Xanoni e të tjerët shkodranë, priftën, fretën, jezuitë, shekullarë, kanë pasë një meritim të naltë tue i u përshtatë mundësis e ândës së popullit të kohës së vet. Por analogjisht, kÿr dishiri e ânda e popullit lypi tjetërgjâ, jo të keqe por të mirë në vetvedi, çdo auktor e çdo editor me ndërgegje do t'i përgjegjte së pritmes së popullit të vet, e s'do t'a mbante ket popull me një shkallë zhvillimâ tashmâ të kalueme; âsht kjo një ligjë njikohësisht morale dhe ekonomike e editoris.

Për ketë arsye unë vetë q'prej 1933 u dhashë tjetër rrymë, nuk po thom botimevet të tjera të Shtypshkrojnë, por deri «Lajmtarit të

(1) J. K. - Anton Xanoni - në «Shkodra» 1962, nr. 2, fq. 84-111.

V

Zëmrës së Krishtit», një organit pra ku mund t'ishte më populluer; e suksesi i shitjeve e i pajtimeve e diftoi se kështu e lypte koha.

Mirë pra, më se një herë i shfletova dorëshkrimet e Xanonit për me gjetë gjë për botim, por gjithë herë m'u desht me hjekë dorë. Një pjesë ishin të një stili populluer të vjetruem; të tjerat, ato thjesht letrare, kishin vlerën e përpjekjeve të para për t'a «aratisë» letërsin shqipe, të bama me përgatitje të mirë e me guxim, por tashmë të tejkalueme, tepër të vjetra për me këndë një sukses kundrejt veprave t'auktorvet më të vonshëm, tepër të reja ende të kenë një dokument historik.

Shkurt, do të pritshin një kohë më të largët, kur të mund të bëhej një «rivlefishim» sikur ai që bëni tashti Jup Kastrati.

Ndërkaq mund të mirrej vetëm rasi — kurrë bite — për të xjerrë ndonjë copë të zgjedhun në mënyrë që mos të dukej tepër e vorfën a e përvujtë ase e pargjun kundrejt letërsisë së ditës. Kjo persë i përket prodhimit letrar.

Përkah punimi gjuhësor, Xanoni ishte me të vërtetë njëri i kujdesshëm e i palodhëshëm, porsë edhe, tue pasë program të madh e mjete — si n'atë kohë — të pakta, punës s'i dilte kurrë në krye. Prandej, më patën thënë (se unë s'kam këndë atëherë), mbet mbas Busetti-t, i cili i bite punës nepër të, por mirë a keq, mërrijnte në fund; e kështu duellën si gramatika si fjalori i Busetti-t, ndërsa Xanoni rrinte e grihej tue soditë atë punë më të keqe, por të kryeme, e punën e vet më të mirë por të pakryeme përgjithmonë e jetës.

E të pakryeme e gjeta ndër — të thomi — dorëshkrime të tija. a më mirë, ndër letra të shpërdame të tija. E vetmja punë që mund të pëlqehet për botim hë për hë, ishte ajo, por do të sistemohej; prandej skedari që fillova me nxjerrë soje, por deri ku e çova, tash më nuk më bje ndër mend.

E këtu vjen pyetja: ku mbaruen dorëshkrimet e Xanoni e ku skedarët e Valentinit?

Në mos i paçin marrë Jugosllavët (sikurr ma tha dikush). Shkodra nët kanë se kuj i a sjellin atë pyetje në Shkodër a në Tiranë. Ishalla s'i ká marrë kush për me bñ letra cigares a për me pështjellë saraga, përpara këtij rilulzimi studimesh që po sodisim sot prej së largu me andje.

Sá për vedi, kur u nisa për Romë në 1943 (nuk ika, por kjeçë dërgue aty për të drejtue botimet e Institutit të Studimeve Shqiptare; e disá duellën, sá patën të holla), nuk mora gjá me vedi, tue mos parapá se s'do të këthehem, veç pak tesha shtati, dorëshkrimet e Institutit për t'u botue, një eksemplar të Bogdanit për do riprodhime për edicion të rí të P.M. Harapit, e dorëshkrimin (jo skedarin) e vumit II të «Contributi alla Cronologia Albanese». Tjetërgjá jo, as veglat e punës, si makinat fotografike etj. (tash kush i ká, i gëzoftë). Skedarët historikë m'u desht me i hartue përsëri në Romë, në Bibliothekë t'Institutit Papnuer Orjental; skedarët e tjerë s'kam si i bñ më rishtas tue më mungue biblijtheka.

Po gëzohem veç, tue pá se ká prap në Shqipri kush mirret me këto studime e nuk përbuzë punën e më të vjetërvet.

GLI ALBANESE

di Maria Mustillo

Gli Albanesi che A. Degrand considera, sono soprattutto gli abitanti di Scutari e dei dintorni e i Malissori (1) dell'Alta Albania.

Li riconosce fundamentalmente buoni, sobri ma più per necessità che per virtù; ospitali al massimo grado: anche la famiglia più povera mette a disposizione dell'ospite quanto possiede; non nega loro coraggio, li ritiene bravi soldati, ma spesso, parlando dei loro usi mette in rilievo i lati meno piacevoli, sempre senza riportarli allo spirito che li informa e cerca di ripetere, ogni volta che gli si presenta l'occasione, di essersi trovato, tra questo popolo, ancora in pieno medioevo.

Ma una requisitoria accalorata la troviamo soprattutto nella conclusione quando dichiara di non poter lasciare la sua «raccolta d'impressioni e descrizione delle cose viste» senza parlare dell'avvenire di questo popolo e delle sue aspirazioni o «almeno di quelle che si cerca di far nascere in esso».

Aprire uno scorcio in cui col pretesto di analizzare la storia di questo popolo non fa altro che ribadire per esteso ciò che ha fatto intendere qua e là nella sua opera.

Comincia con l'affermare che gli Albanesi sono stati sempre soggetti a potenze straniere, che sul loro territorio si sono succeduti nel tempo Romani, Bizantini, Serbi, Veneziani, «ma che gli abitanti non hanno conservato un profondo ricordo dei secoli di dominazioni: vi sono stati dei tentativi per liberarsi, ma tentativi e non altro. L'epoca di Skanderbeg è il solo momento in cui gli Albanesi hanno avuto una vita propria, dopo questo periodo non si è parlato più di essi, non hanno storia, non tradizioni, non documentazione, solo qualche leggenda che va sempre più alternandosi. E generazioni si sono succedute a generazioni senza lasciar traccia del loro passaggio: sembra che siano andati avanti senza un fine preciso, e sono passati su questa terra in qualità

Questo saggio della Dottoressa Maria Mustillo su l'opera «Souvenirs de la Haute Albanie» (Paris, 1901) del Console francese a Scutari A. Degrand, è tratto dalla sua penetrante e nitida tesi di laurea «L'Albania e gli Albanesi nell'opera del Degrand».

(1) Abitanti delle montagne.

di mercenari servendo, senza distinzione, « ora la Croce ora la Mezzaluna » ed a riprova cita Balaban Pascià (2).

Oltre tutto, ciò che egli afferma, è da considerarsi alla luce della verità storica e con mente sgombra da pregiudizi: è vero che sul suolo albanese si sono avvicendate dominazioni straniere e il Turco si è fermato per quattro secoli consecutivi, ma ciò non significa che gli Albanesi si sono assuefatti a questo stato di cose: battaglie e ribellioni ve ne sono state sempre, registrate da storici coscienziosi e se l'esito non è stato vittorioso la ragione si trova nel fatto che le potenze dominanti (voglio intendere il Turco in special modo) avevano tutti i mezzi per stroncare le rivolte d'un piccolo popolo.

Anche la mancanza di fonti storiche va ricercata nel fatto che gli invasori hanno cercato di distruggere ogni documentazione scritta e non hanno permesso alcuna istruzione proprio per cancellare dalla mente del popolo schiavato ogni legame che avesse potuto esercitare la loro lingua qualora fosse stata coltivata.

Qualche scuola italiana ed austriaca, in città almeno, non è mancata, anche una certa istruzione da parte degli *hogià* veniva impartita ai musulmani, ma le prime insegnavano la loro lingua e ciò che insegnava il ministro islamico certo non era tale da conservare l'idea della nazionalità del popolo soggetto.

Accenna, poi il nostro autore « a qualche leggenda che tiene il posto di storia », ma proprio in questo è la forza del popolo albanese, in queste tradizioni di coraggio, di valore, di eroismo, di virtù morali della stirpe che si tramandano di padre in figlio come patrimonio sacro del popolo. Mancata agli Albanesi, per ragioni storiche, una letteratura scritta, nella letteratura orale — favole, racconti, proverbi, sentenze e nei canti popolari in special modo — essi trasfusero i loro sentimenti, l'amore della gloria, l'alto concetto dell'onore individuale e nazionale, l'odio verso il nemico, soprattutto verso il cane Turco (*qêni Turk*) — « E i canti popolari — dice il Petrotta (3) — sono l'enciclopedia storica, morale, civile e patriottica per ogni Albanese... ».

« Sono canti amorosi, canti natalizi, storici, satirici, ecc., che diffusi per i monti e per i piani, nei villaggi e nelle città, formano il legame più saldo tra le varie tribù, le varie famiglie e i vari ceti del popolo albanese, sono la parola d'ordine tra i montanari della Grande

(2) Balaban Pascià, albanese, contemporaneo di Skanderbeg. Fanciullo ancora fu tratto in schiavitù dai Turchi ed allevato nel corpo dei giannizzeri e nella religione musulmana. Per il suo valore nelle armi il Sultano lo elevò a grandi onori. Rivolse la sua spada anche contro la patria sua.

(3) Cfr. G. Petrotta - *Popolo, lingua e letteratura albanese*. Palermo 1932, pag. 95.

e Piccola Malsia e della Mardizia, e i marinai di Vallona e di Santi Quaranta; sono la tessera di riconoscimento degli Albanesi fucri della patria, in terra straniera, che per mezzo di questi canti mantengono vivo il culto della lingua e delle costumanze della patria d'origine». Anche l'Hecquard aveva ben compreso quale messe di documentazione fornissero i canti se poteva affermare che « Si l'on voulait reconstruire l'histoire de l'Albanie, il faudrait recueillir avec soin ses chants » (4).

Per quanto riguarda l'accento a Balaban Pascià si può rispondere al Degrand che un uomo non conta per un popolo e defezioni non mancano presso nessuna nazione.

Più giù « Gli Albanesi sono stati giudicati con severità dagli storici che nell'antichità si sono occupati di essi » e cita brani che non fanno altro che ripetere quanto prima lui ha affermato e che staccati come sono dall'opera di cui facevano parte, assumono il tono che conviene al nostro autore. E soprattutto il Degrand non ci dà la possibilità di confrontare questi autori perchè non dà l'indicazione precisa.

Ami Boué (5), quarant'anni prima del nostro autore, così aveva presentato gli Albanesi: « Gli Albanesi sono forse la più bella razza della Turchia... ricordano i più bei tipi dei montanari svizzeri, ma hanno in più una vivacità ed una gaiezza meridionale unita ad una perspicacia straordinaria. L'orgoglio si manifesta nel più piccolo motto, nei loro gesti. Il coraggio è innato... Si rimprovera all'Albanese una selvatichezza ed una durezza di carattere, ma questi particolari sembrano risultare più dal loro genere di vita che da un tipo primitivo ». Giudizio accettato in pieno dal Godart dalla cui opera, appunto, l'abbiamo trascritto e che ancora lo commentava dicendo: « Ami Boué visitò l'Albania prima del 1840 e noi troviamo nei suoi racconti di viaggiatore coscenzioso e buon osservatore, note vive e previsioni che il tempo non ha smentito » (6).

Il tempo non è riuscito a nascondere il vero e il Bourcart nel 1921 (7) asseriva che tutti i viaggiatori in Oriente erano d'accordo nel vantare le qualità degli Albanesi: « cavalieri audaci, migliori soldati d'Europa, camminatori infaticabili; sentimento dell'onore, fedeltà al capo, rispetto religioso alla fede giurata ».

Tutto ciò per attenerci al giudizio dei connazionali del nostro autore. Se leggiamo le opere di studiosi italiani, che hanno avuto modo

(4) Vedi citazioni in E. Koliqi - *Epica popolare albanese*. Padova 1937, pagina 7.

(5) Cfr. Godart I. - *L'Albanie en 1921*. Paris, 1922, pagg. 41 e segg.

(6) Cfr. Godart - op. cit., pag. 41.

(7) Cfr. Boucart J. - *L'Albanie et les Albanais*. Paris, 1921, pag. 171.

di parlare di questo popolo, vediamo come abbiano sempre riconosciuto quelle qualità che nè dominazioni, nè eventi poco felici sono riusciti a cancellare..

Ad esempio l'Almagià (8) così si esprime: « Come qualità psichiche e morali più spiccate degli Albanesi si possono citare il sentimento d'onore, la patriottica fierezza, il coraggio sprezzatore di ogni pericolo, l'assoluta onestà, la fedeltà ai capi riconosciuti, la scrupolosa osservanza della fede giurata... ». Quanto poi alla limitatezza dei bisogni ed alla modestia delle aspirazioni soprattutto dei montanari, la spiegazione si trova nelle condizioni storiche che hanno costretto questo popolo a ritirarsi nelle montagne per conservare una certa indipendenza. E lì dove la natura era alquanto avara con le sue rocce e per la scarsa produttività del terreno, gli abitanti si sono adattati al poco ed hanno imparato ad essere sufficienti a se stessi. Per il Degrand la ragione vera di questa condizione è nel fatto che gli Albanesi di montagna, impossibilitati a venire in contatto con altri popoli, poco sentivano la loro miseria e, non potendo fare il confronto, non potevano desiderare una migliore esistenza.

Ed ancora « l'isolamento in cui sono vissuti gli Albanesi non è stato così completo da impedire loro una certa conoscenza dei progressi realizzati dai paesi vicini, sono essi che non si sono mai chiesti il perchè del loro abbandono al confronto delle altre regioni dell'impero Turco; sono essi che non si sono mai convinti che la causa di questo abbandono si doveva attribuire in gran parte a se stessi » sempre, secondo il Degrand, per la loro rassegnazione paziente allo stato esistente delle cose.

« ...hanno una lingua, costumi, credenze diverse dai popoli che li circondano, potrebbero riunirsi in uno Stato » ma dalle parole che seguono ben mostra come non ha alcuna fiducia che il popolo albanese possa un giorno riunirsi in uno stato. La storia lo ha smentito.

Quando non colpisce in blocco tutto il popolo albanese, i cattolici sono il bersaglio suo preferito; ad esempio: i genitori cattolici di Scutari hanno una rigidità di comportamento verso le figlie, le sottopongono ad un sistema di clausura che supera anche quello dei musulmani; il loro quartiere è più monotono e più triste di quello musulmano: « sembra il quartiere dei vinti e dei perseguitati »; mostrano acquiescenza alla dominazione turca: « il loro animo, dice, sotto questo giogo che dura da secoli si è ormai incallito e ci si è abituato »; del resto non hanno di che lamentarsi; sono stati esentati dalle imposte, esonerati dal servizio militare, versano soltanto una somma annuale di 30 piastre

(8) Cfr Almagià R. - *L'Albania*, Roma, 1930, pag. 128.

per ciascuna famiglia, somma destinata a remunerare il servizio dei gendarmi per la loro protezione... ».

Eppure aveva iniziato la conclusione con un «admonere volumus non mordere!».

La donna, per il Degrand, è vittima dell'uomo: (poco comprendendo in questo, il nostro autore, la compattezza della famiglia malis-sora in special modo, per cui ogni nucleo familiare è uno stato a sé che deve provvedere al suo sostentamento ed alla difesa dei suoi diritti); la donna deve sottostare al padre finchè non si sposa, una volta sposata non fa che cambiare signore. «A lei sono lasciati i pesi più duri, — nota il Degrand, — come il lavoro dei campi, il portar legna, acqua, ecc.».

Queste condizioni certamente si verificavano un secolo fa specie dove la terra produceva poco e dove le cavalcature non potevano essere troppo usate per le strade impervie, ma le condizioni variavano da un luogo all'altro, e, se sulla montagna la donna era costretta a lavori pesanti, nella pianura e nella città il tenore della sua vita era molto diverso. E già il Pouqueville (9) alcuni decenni prima del nostro autore, nella sua lunga permanenza in Albania aveva compreso che «la donna non accetta il peso delle sue incombenze come un castigo quasi o con rassegnazione forzata, ma vi si adatta come a casa sua, a suo onore, con quello stesso senso del dovere per cui il maschio s'adatta alla sua vita periccolosa per innumerevoli ragioni anche ben lontane dal suo interesse ».

La donna albanese rispetta ed ama il marito, ma senza smancerie sentimentalistiche, è pronta ad esporsi a qualsiasi sacrificio quando la necessità lo richieda; è fiera dei figli e delle virtù che questi mostrano, virtù che rimontano ad onore della madre per l'educazione che ha saputo impartire. Pronta a spingerli a qualsiasi prova quando c'è da difendere l'onore e la libertà e non sa perdonare alla viltà. Nel canto «*I sette di Shala*» una madre accoglie con parole di aspro rimprovero il figlio che torna solo a casa da una pericolosa spedizione senza i suoi compagni: si taglia i capelli in segno di lutto grave perchè il figlio ha preferito la vita ad una morte gloriosa:

*Deli Pietra è scomparso,
non sanno se cadde o se si mise in salvo.
Deli Pietra dalle bianche ali
a volo è salito fino a Shala.*

(9) Vedi Pouqueville F. - *Voyage en Grèce*. Paris 1826, t. III, I-VIII.

*La madre gli si è fatta incontro,
dice a Delì: — Perchè venisti?
Perchè venisti? Dove sono i tuoi compagni?
Figlio per te io mi taglio i capelli (10)*

e gli consegna la conocchia che ha in mano dicendogli che d'ora in avanti può restarsene benissimo a casa, come una donna, intenta a filare, dal momento che con la sua condotta ha perso la qualifica di uomo.

Come le donne spartane che consegnavano lo scudo ai loro uomini con l'ammonimento « o con questo o su di questo », la donna albanese è orgogliosa degli atti di coraggio dei suoi. In un canto conservatoci dal Cozzi è ancora una madre che lamenta, sì, la morte del figlio, ma si compiace della forza d'animo mostrata contro i Turchi che volevano disarmarlo:

*— Ascolta, o Salih Ahmeti,
oggi per te è stato uno strazio,
perchè sessantasei ferite
tutte nel corpo le hai ricevute;
ma sopportane il dolore, caro figlio,
che così muoiono i valorosi per l'armi.*

In Albania c'è il culto del coraggio: qualsiasi azione che possa significare debolezza è fuggita perchè reca macchia alla famiglia ed al parentado. La vita non ha troppo valore: è la morte che dà la vita all'uomo, lo spirare sulla terra nuda per l'onore e la gloria. « Morire per il yatagan d'un bravo, per il piombo d'una carabina, mordere la polvere, dopo aver scaricato le armi, mentre il corpo palpita e si dibatte nel sangue chiamando vendetta e morte su i nemici: questa è la morte dell'uomo coraggioso ». Così esprime il loro sentimento di fierezza e di valore un compianto funebre conservatoci dal Giordano (12).

Un acceso desiderio di notorietà e di gloria si segnala in essi. Guerrieri e poeti per istinto, ogni eroismo è materia di canto ed ogni canto è incitamento. La grande aspirazione di ogni Albanese, specie se monta-

(10) Cfr. E. Koliqi - op. cit., pag. 212.

(11) Vedi E. Cozzi - *La vendetta del sangue nelle montagne dell'Alta Albania*, in « Anthropos », 1910, pag. 685.

(12) Vedi G. Giordano - *Vilayet di Scutari*, Roma, 1899, pag. 71.

naro, è di essere ricordato anche dopo morto come protagonista di avventure rischiose, di formare oggetto di canto popolare per mezzo di un atto di coraggio e far correre il suo nome di montagna in montagna.

Ecco con quali parole una donna, *Drande Kegja*, piange sul morto *Rrok Tom Dashi*, un montanaro noto per il suo coraggio: e gli assicura che il suo nome, col canto, durerà quanto la stirpe:

*Tu eri quale dovevi essere:
buono con i compagni, prode nella battaglia.
Hai sparato ai nemici in mezzo al Bazar,
a tutta la stirpe hai fatto onore,
a tutta la stirpe di figlio in figlio.
Io piango perchè si è spento il tuo corpo,
ma so che la tua fama non morirà mai.
Con lodi tu sei ricordato,
il tuo canto ogni giorno si canta (13).*

(13) Cfr. E. Koliqi - op. cit., pag. 54.

GOJA E POPULLIT

Qiti e ngjiti.

Bân mirë e gjëjë dhunë.

Me hangër bukën
E me përmysë kupën.

U rrit fëmija, u shit shpija.

Fusha ká sý e gardhi ká veshë.

Mos e prek gjarpnin në bisht,
Se të zën në gisht.

Nuk lenë burri me musteqe.

Unë fol e plas,
Ti pi ujë me tas.

(Kur ndokush nuk ja vën veshin fjalës, qi i thotë ai tjetri).

Kush hjek, áshjt mjek.

Mbanje besën ndërmjet veti:
S'ká ç'u bân kurrfarë milet!

(Nga përmbledhja e Prof. Anton Paluca)

Mbishénat

nga Prênk Ndrevashaj

— Të fala na i bân Cic Markut! — tha plaku tue xânë vënd në stom të një rreshpje e tue përcjellë me sy të ndezun hapat e djaloçit. Në buzët e tija dukej një gaz i dhimbshëm, por një herit edhe ironik.

Dielli ishte afrue bukur mirë Kunorës. Si një permallim në ftyrën e atí që largohet nga të dashtunit e vet, ishte faqja e tí má kuq se gjaku. E në vënd që me shpejtue, sikurse është përshtypja e një nieri që s'e dishron kurrsesi mbarimin e një dite së kândshme e përkdhelse, dukej si t'ishte ndalue, i mahnitun nga gjith ai shkëlqim i pashoq që derdhej ndër mija xhixhillimesh e valavitjesh shkambijevet e lugjevet, tue xânë fill në Mbishéna e tue u varë shpâshëm teposhtë, si vija të një piramidje, der kû syni nuk mbërrín má. Mulungjet e zbardhueme gjatë vérove nga kambët e bagëtivet që kishin çfarosë me rrâjë kahe-rë barin e butë téhave t'atyne plíshavet, shì si t'ishin bâ me pushue shikjimin bjeshkatarët e lodhun, tërhiqshin vrejten e djaloçit dhe e grishëshin me hí në kujtime e kuvendime me to.

Marku kishte fillue dalë ngadalë me u lirue nga lëndimet e mbrendshme që pak përpara i kishin dhanë shpirtit të tí të pizátuna pikuese. Nuk ishte kollaj me lânë dy pleq rrugash e në dorë të mizorit... ndoshta dhimba e tyne nuk do t'e kishte qëndrën e vet ndër vujtje... as në pezmin që kishin të drejtë disì me pasë për largimin e birit të tyne tue i lânë shkret në ditt má të ngushta... ndoshta mbi të gjitha peshote kujdesi për djalë, me të cillin s'kishin shpresë me u bashkue má kurr.

Ishte rritë në gjytet Mark Shâni. I ati kishte lânë Malsín në moshën e vet të ré, tue ngûlë në Shkodër, kû në pak kohë kishte bâ një qark të mirë jetese dhe kishte tërhjekë dashmirésín e shumë familjevet shkodrane për guxim, besnikí e urtí. «Burri duhet me kënë trim e besnik e fisnik» ishte fjala e shânit. Kishte shkollue të birin, Markun, djalë dishiri, tue i dhânë sa má tepër mundésí për të fitue dije e një edukim të mirë. Vérvet i prite ndër miq e kû kishte vllaznín në Malsí, pse dote t'i rritej i biri i shndoshtë dhe «shkollës, po s'i dhae pak duhëm malesh, është má mirë me i bâ gjâmën» thote Shâni.

Prandej kujtimet e ktyne bjeshkëvet në këtë mbrámje të bukur e grabitën djaloçin tue ia shëndrrue, me padashje të tí, gjëndjen e shpirtit, në të cilin depërtoshin tinzisht argtimi e davaritja. Në pritë të gjithavet zblote ftyrën në mòh një permallim ndrydhës, i cili prap zhdukej për t'u kthye má vonë i hovshëm, me ia zhytë zëmërën në vajë.

— Plaku, që ma shkrepí udhambarën e Cic Markut, a do të jetë kujtue për arratín t'ême? Jo. Sigurisht ka mendue se edhe un, si shumë djelm prej gjytetevet, ëndem i papunë e i pa kujdese ktyne bjeshkëve

kohë e pa kohë. Ndoshta do t'i ketë ardhë keq pse s'u ndala me bûjtë në shpí të tí —.

Ecte pa u kujtue. Nga të kótunit e parë i çoheshin tue fluturue turrshëm mëllíjat përfundi e përsypri asajë rrëje, dhe e shkúndshin orë e ças nga mendimet. — Edhe tí e din se jam pa rrugë — i tha në një shëj vëndit zogut që i crryti para ftyrës e kaloi. — Njashtu ásht. E nesër kam me kënë gjah edhe má i turitun... kanë me më ndjekë për gjurmë si egersinë që ndjekun me i marrë lëkurën —.

Nata ia kishte rrëmbye dritën për rreth tue i lânë vetëm dý mundësi: me pá për s'afërmi rrugën për të mos u përplasë áhavet ase më ndo'i cûng búngu gând; e ka'i herë me soditë prej ndo'i rrathëtorit dritëzat e qiellës që drídheshin n'ajr të kulluet e shkëpeshin aty-ktu tue u drejtue picimájthi mbi male të káltërta si shkëndija fushqetash ndër festa. Por nata i ngújon njerzit ndër shpija, rrugtarin ndër mendime. Nata ásht si një bishë e zezë që të kërcnohet der sá të dalë drita përsrí.

— Prá do të më nëmin prindët e mí sonte? — Me sytë e shpirtit rá në gjytet, híni mbrendë në shpí e gjet t'án që kah shtërngote me dhambë boshtërzën e kamishit u çue në kambë dhe ja nguli sytë për lotshem... e áma kishte mbështetë shplakën e dorës së djabatë per báll e, ndëjë në një karrigë t'ultë, kqyrte tokën. Çoi sytë e kuq nga vaji e « jo more bír, pse me të nëmë? Kúr të kena nëmë? » i thote.

Mbandej u shkund Marku nga kto mendime. « Jo-jo, tha, prindët e mí nuk kjajnë. S'i kam pá kurr tue kjá ».

Kishte kalue në këtë kohë Lugun e Territ, plot tregime prrallore, çfaqje të frigueshme msheftësisë nëpër gojë të vendasvet, të cillët sa herë i kishte ndije q'nga vocrija tue thurë ndodhína të panumerta.

Hapat e tí drejttoheshin gati pa u kujtue thik perpjëtë kah Mbi-shénat, katund i vogel katerdhetë shpísh në shpat të një mali. Ktu njerzit ishin të thuesh krejt të shkëputun nga marrrdhanjet me gjytete, sidomos gjatë dímnave, e rrallë tokoheshin edhe me banorë të katundeve per rreth prej largësis e motit të lig. Me shoqísho'in nuk kishin ngatresra e fitme, por bashkarisht i gjëshe shpesh në punë, e ndër nett e ftofta u mblidhshin tue çilé sejcili pervoje e vet në kuvënd e kangë e lojna. Miqt e largët ishin të rrallë. Ndryshej ishte gjatë stinëve të buta. Ktu Marku kishte probatinin e babës.

— Kjoftë mirë e mbrámja e mirë — tha tue hí mbrendë. Tha me një zâ të naltë por të paqendrueshëm tue drashtë mos po u bjen ndesh pa híri pershëndetjeve të tynë të zakonshme, të cilat në gojën shpotare të gjytetasvet kumbojnë si te belbëzimi i moshës së njomë ndër male; gjá që vetem kush ásht në gjendje të Markut din me dallue.

Gjyteti e rrethi shoqner dhe edukues, që ia kishin xbutë shprehjet e mënyrën e të gjikuemit curak, pa shembuj, pa mite o pusi, pa shpotí burrnore o madhní të hieshme e kreshnike në ndëjë të malsorit, e kishin vú djaloçin t'onë në kapërcyell, të cilit i duhej kohë e matje me pikë një mëndim me vënd tue pajtue shprehjet e shkollës e të gjytetit me ato të malit.

Mbas një qendrimi të shkurtë e ndërdyzash, u drejtue kah skuta e u fal me gjindën e shpís mbarë tue fillue te një plak, edhe ai mik, e tue iu sjellë votrës per qark deri te mbarimi i rreshtit të grávet.

Vetëm një prej krejt gjindës n'atë shpí e njofti, e kqyri tue i shtërngue dorën dhe i shkëlqei gëzimi në sy. Marku xúni vënd në fillim të radhës së búrravet, prej kah i zoti i shpís, Bash'Gali, tue e kapë për krahit e vundi në krye të vendit: «Njiktu rrin Shkodra» piskati dhe i vuer pushkën në kúj.

— Po Zo' — tha Bináku, nípash i Bashës, — a ka se si ia din brícën pushkës i shkodrani? — I pshtoi pa mendue kjo fjalë edhe me një herë u pendue. Djaloçi qeshi. Gjindës së shpís nuk u pelqei kjo mahí e pa vënd, pse si thame, vetëm Basha ndër ta e njifte mikun e rí.

— Ndoshta nuk ástht i shkodranë — ia priti me'i zâ t'ambel Bora.

Zenel Gashi, që vetë i treti kishte ardhë per mik te Bash'Gali, e një miqësi e vjetër i lidhte të dy shpít, kje i pari që thei heshtjen: «O Binak Pepa» thirri Zeneli. «A nuk e din se prej gjith Shkodër-loces sall një pjesë-e vogel që struket në fyt të Buënës truç janë kokërr shkodranë?».

E pëvetën me rend djaloçin, tue i flakrue përpara cingare duhâni të pshtjelluna e kutija madëmi. Edhe ky, tue thirrë me kujdes në mënde zakonet që kishte mësue ndër male perparandej, por tue u bâ lak problemeve të reja edhe gjendjes së tí vehtjake, u shpí mjaft shpejt edhe u gjet në valle të burravet.

— A ka hí rrufí má në Shkodër? — pëveti Zeqir Sejdija, që kishte ardhë per mik me Zenel Gashin.

— Ka bukur do kohë q'se gjindem larg nga Shkodra, e nuk dij shka me thânë, — pergjegji Marku. Zeqiri tue imtue bindjen e vet për gjendjen e ré, ankohej për kohët e vshtira që kishin mbërrí e se njerzimi ishte marrë mëndsh pa mujtë me gjetë derë as vâ për t'iu largue së keqes që i afrohej vëndit.

— Po pse s'thue, kurkush s'ástht kah mendon për tjetër veçse me xé zhárt në votër të vet —, tha Luleci, vllau i Bashës. Edhe vijoi: — E prá katër herë, q'se e mbajë por un mend, u dogjëm e u shkrûmbuem me faj t'onë! —

— Me faj t'onë jo — ia priti Bináku. — Por me t'atyne që kúr bienë ngusht, mirë u bjen ndër mënd për né... e mbandej as një grusht krypë me pare s'ta qesin në kta hordupë, sa me rrëjtë dhítë per Sh'Njergj të bardhë. Por të duhet me lanë shatin ndo kosën ndo vadën e me rá në Shkodër m'e marrë, tue hupë argatë sa të duesh. —

Basha kishte ndëjë tue kundrue djaloçin, ardhë vonë e nga një rrugë e largtë. Ndiqtë çdo shëj e sjellje të tí tue u knaqë në loçke të zëmrës per të. Kishte dijtë me kê me pí gjakun e vllaznimit. Mbasí edhe mos me kêne kurrkund gjáll Shân Gega, gjallote në djalë të vet.

Por Bashës nuk i kishin pështue pa ndije edhe fjalët që kishin fillue me marrë të ziem rreth votrës. «Ty të lumtë goja, Zenel Gashi! Shkodra ástht gjaku s'inë, prej fisesh s'ona». E mbandej tue u sjellë prej Binakut e tue mbështetë tehin e dorës per báll me pëllambë poshtë, si të dote me pá má mirë, «S'janë fjalë me u folë ato, more Binák», tha. «Por ti nuk ke faj. Shkodrën nuk e njef. Kúr i dhanë kohë Shkodrës së mjerë e gjyteteve tjera të Shqipnís me u mbledhë e me mendue për popull të vet?».

Në kuvënd të peshuem Binaku ishte i mujtun. Qendrimi i tí kallxote se pa një dalldí pëngjesh në kuvënd nuk perkulej, e ndoshta as

atëherë jo. Æsht nji farë krenarije e rrezikshme perzie me gjak t'iidhtë që gjithmonë qarkullon nëpër derrnekë të nji pjese së burrnimit të malevet. E shka është më e vajtueshme, edhe gjytetarë tjerë, të cilët për zhvillim të tyre në çashtje shoqnore kanë nji pergjegjësi morale shumë më të madhe, nuk i ruhën kti hovit të papeshuem. Çdo kundërshtim me vënd e me hije, kúr nuk është fryt i mllëfit të verbuem e kúr nuk mungon vullndeti i nji gjurmimi të pa-anshëm për t'i vleftë shoqnis, ka frytet e pamohueshme të veta. Por kúr del në shesh për qellime vetëm vehtjake, për nji « e là fjalë », është doemos i damshëm. Ani t'e ndiejmë Bashën:

« Kora e sotme, tha, është bā bitërr mbas kotësivet. Dikúr kena pasë orën çuet edhe ndër vuejtje. Në çdo rrezik na ka kallxue Shkodra si me bā, na ka dalë zot kú â kënë më shórti me huqë. Ajo ka luftue me shkrim e dije e na me pushkë e besë mbas sajë. Ç'faj na ka per rreziqe që na qasen? A s'i çoi tash trí herë djelmt e vet tue na bā thirrje? ».

— Dajā, kujë me i bā thirrrije — ia priti Bināku. — A kujton Shkodra se e kena në fill me u dalë për bāll krājlavet-a? Hiqi bricë kúr të duesh. —

« Të parët t'onë kanë luftue edhe me kraja e nuk janë dá fort keq. Ju mos më lëni me rrëjtë, burra! Edhe ti, Binakā, ke kënë me mue kúr s'kjemë të tjerë por tridhetë burra me mauzerre ndorë e i duelem Turgut Pashes para e, per atë rreze dielli, s'mujti me e bā 'i hap këndej as nuk t'a ka kalue Salcën deri më sot. Kúr erdh duhija e Malevet në ndimë, gati e gjet pūnën e kryeme. Por ka pasë burra atëherë. Kurrkujë nuk i ishte mbushë mendja se pocerka e tí ka mënd shumë. Njā ka prī, tjerët kanë ndjekë e të tånvet u ka mbetë nāmi. Sot kjo korë as s'është e zoja me prī as me ndjekë e, po ia u ap besën e Zotit, të tånë kanë me u fikë e me u koritë në mos u raftë në mënd me bā si ā dhanë e mbara! » e i rá me māshtë të gjata prushit në votër tue e logitë me 'i hov deri te urzaku. Mbandej vijoi: « Kena vojte si i Gjobalaj. Mēnde-mashkull e i pakēnun per vatan. Shiti vllaznit e vet Kelmēndas, që me thasë leshit në krahnuer e kishin dá me dekë në luftë ditë e natë. Por ai tek fundi dijtë me mbetë prap se prap shqiptar e na ā më kuti me u bā gogë ». Ktu ftyra e Bashës muer nji pamje ankuese: « Kena mësue 'i zakon të keq » — tha. « Nuk e losim kambën pa pare. Atëherë kúr na vjen zjarmi te dera thomë — bāne Zo'andërr! Sot nuk ka burra veç sa mizat e bardha ». « Binakā » iu suell kti: « Shkodra është votra e jonë e na unākët e sajë »

Ndër malet e Shqipnis është detyrë e shpijakut me u bā nderë e kuvend miqvet. Miku flet rrallë e për mállë. Urtija e Bashës edhe sot përmendet në male t'ona. Kurrkujë më hije s'i kishite pritja e miqvet. Ky tue u kujtue se biseda e tí mujte me kënë e fortë per mikun e rí, çoi kryet tue zotnue me nji të kqyrun të gjith: « S'po e njifni, tha, ket djalë të rí. Pruff'a Ora me nafakë! Se për Zotin, jam gëzue në quk të zëmrës tek e kam pá bāllin e tí. Æsht i biri i Shān Gegës e rrin me shpí në Badra të Shkodrës. Kam pí gjākt e gishtit me babë të tí. Kena kënë bashkë në luftë me Junān. E pat marrë pushka brí më brí! E p'r zet si kje rá lmuç u drejtue vrik si vetima tue u sjellë prej meje: — Un e pata, Bashë, por pështò veten — më tha — e mos të hupim të dy pa shëj pa dukë në dorë t'anmikut me luejtë me né për së dëkuni —

Mbandej tue u pshtetë kadalë tha: — s'jam kah të thom me ikë por... me u ruejtë! —.

«Jo, more, s'ke gjâ jo» i thaçë. «Po-po, kam mbarue... por merrmi armët se s'ke si m'ia lën anmikut». E tue më pá harû në kambë «Teru kndej, po të thom!» mu germue në kupë të krës, si shtatë herë zâna.

Un hoqa shpejt e shpejt një shall të gjatë e të mëndashtë që kishte Shâni në qafë e, tue e shterngue ding në permjet, e kapa me të dy duerët e nëpër plumba si breshni e xora potere. Faleminderës të Lumit Zot, s'e kishte pasë thânë i Lumi me më dekë probja. E... pasha shnde'n e shtatit dymbëdhëtë djelm prej qukut të Shkodrës... me bâ dritë si dielli... mbetën dëkun prej rreshtavet t'onë, si të kishte kënë lojë e jo luftë! U thye Junâni». Mbandej i dha fund Basha: «E keqja e jonë mâ e madhe sot, âsht kapja për yjë të qiellës... e s'pritojmë me vû në zgrip besë e fé e trashigimet e mira që na là baba». Tue shprushë në spûzë e tue e shti shqopën ndër gaca të gjalla deri te rrfâna, ngrehi ngutshëm dy herë e thirri «uj'duerësh!» me 'i zâ urdhnuet e pak t'eger, por që zbutej me shikjim të tí kah robt e shpís. Vetë dishroi mos me u shkputë nga mendimet që kishin xânë fill vargue në mende të tí. Prandej ia bâni me dorë Binakut me u prí miqvet në të lám të duervet.

Në miq e djelmëni zhvillohej nën zâ një bisedë e shpejtë tue u pëvetë sejcili me shoqin për brî nësá shtrohej sofra. Âsht koha mâ e përshtatëshme me u njoftë miqt e largtë me djelmënin e shpís. Djaloçi nuk prandoi kurrsesi, kúr e lutën tue i prû ênë për të ngrânë në veti, por shtërngoi tryezën mbi të cilën kishte gjith të mirat e një shpije mal-sore; kû për mik gjithkush e din se dishka duhet shtue, e po s'qelloi gjâ e veçantë, mjafton një lugë mâ tepër e bukë e krypë e zëmër.

— Mos na kurseni për një kashatë bukë cerémet! — tha Binaku. Mbandej u suell prej Markut njerzisht: — Na vjen keq se ti je mësue me bukë grûnit e s'dij a ke me mujtë me burrue gjâ sonte... Por të vraftë buka e probatinit në mos marrësh sa të ketë ânda! — Kshtu i përbejti të gjith. Basha tue u sherbye në kambë tregote se buka e kollomojit s'e mban burrin por tre sahat, pse vetem tre muej rrin në tokë, kurse grûni rrin nandë muej, dhe perciellte fjalën me 'i të qeshun të bukur.

Mâ i mbрами ishte çue prej sofre Binaku. Të gjith kishin lá duerët tue bâ urimet e zakonshme e tue kthye sejcili lirisht në vënd kú dishrote, pa kqyrë mâ rëndin, pse mbas buke miku bâhet njësoj të thuesh si piestar i shpís, pa kënë nevoja me i ndëjë në kambë o me i gjetë vëndin.

Kishin xânë vënd robnija në stola rreth votre. Grimci, që ishte i shpís, ishte tue grí në çark palët e duhanit të zbútuna me priskatje të bulshíve si rrshiq farke. Pështetë m'njênin gjû ia shtypte Shytanit herë mbas here lmuçat e tymeikut, e ky i shkoklote në dritë të psihtarit me shkullâjë të kuqun tue u dhanë të rreshkun e fuqí në të pím. Babuni, vllá i Bashës, kishte fillue një bisedë edhe për një ret krejt sá ishín ja ngulne sytë e heshtën.

— Jo, s'pata tjetër fjalë — ia mbet, — por deshta me i kallxue Zenelit ândrrën që kam pá nâtën që shkoi —. Ndërpreu fjalën sa një të kallme duhani dhe vazhdoi:

— Mu gjá se jam dikund njatje në Rrosek për nën Shpellë-Korbe me do shtegtarë, tue pushue n'ato rrasa. Në t'pákujt i rá dheut një terr i dendun si nett e dimnit. Mendja ásht me' shpejtë se fjala, Zenel. Se sa rrahë nieri qerpik s'vonoj dheu me u zditë e nëpër gjámë, si bumbullimë motit në borë, pava tokën mbushë me eshtën e rrashta të dékunish që kqyrshin qiellën. Ndimò Shejt-ti i Shën Kóll, mu dha me thanë. Salí Ndreu, të cilin më bâhej se e kishe për brí tue pshtjellë një letër duhân, mu suell mâ vrântë se rêja: «Po Zo', shka â ka' do me u bâ me né, more Babun?» Un e të gjith shtegtarët tjerë i kishim shtangue sytë kah gryka ndërmjet Kalás së Shkodrës e Taraboshit, prej kah viellte deti flakë të kuqe e të verdha nëpër vetimë e krizma, e toka sumurote si mbi rrebe të termekut. «Mjerë zëmërza e jonë... mjerë zëmërza e jonë!» briti një grue, e s'dij kush ishte ajo. Pava se ndrrueme vënd... e na qiti pûna shi në krye të Shtojit... Prej aty e shifshim mâ kjartë detin e lkuqun tue u derdhë mbi Shkodër... e pësë kumbonare të shtrembnueme që perciellshin në t'rallë herë mbas here ding... dâng... ding... dâng... një zâ vajit. Nji brimë e ankueshme vite si nën dhë prej xhamis së Plumbit! Mu përqeth shtati e leshi i krës mu çue përpjetë! Kúr qe, lik për mjedís rrugës para nesh... një trum i madh... ishte çue në të dy kambët e para, e tue zgjatë kryet përpjetë piskatte në kupë të qiellës hûm-hûm-huuu... e i pikoshin lott në tokë tuj kyce perpjete si kokrrat e zhivës! Më duel gjumi —. Edhe, — lavdja më të Lumin — tha Babuni, — mendja e krës kje ka' më lue —. Kqyrte kokërr pa luejtë Zenel Gashin, i cili s'kishte bâ mâ të voglën levizje deri m'at ças. Dikúr foli: «Dërhaja », Babun, e kurrjá tjetër! ».

